



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Kamëz

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

“Bashkia Kamëz”

Tiranë, mars 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.	9-10
II.	HYRJA	
1	Objektivat dhe qëllimi	10
2	Identifikimi i çështjes	10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
4	Përgjegjësitë e audituesve	12
5	Kriteret e vlerësimit	12-14
6	Standardet e auditimit	14
7	Metodat e auditimit	15-16
8	Dokumentimi i auditimit	16
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	14-26
2.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	26-44
2.2.6	Burimi i krijimit i të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qera të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.	45-72
2.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	72-87
2.4	Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës	87-92
IV	REKOMANDIME	92-101

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
IT	Teknologjia e Infomacionit
NJA	Njësi Administrative

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Kamëz është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave. Bashkia ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, në veriperëndim të saj. Kufizohet në veri me Kamzën, në jug me Tiranën, në lindje me Zall-Herrin dhe në perëndim me Bërxullin. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit. Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbret në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit. Bashkia ndodhet në trekëndëshin strategjik: kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit. Bashkia Kamëz ka një sipërfaqe prej 37.18 km², popullsia është 133,499 banorë dhe ka dy njësi administrative: Bashkia pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan.

Misioni i Bashkisë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

Bashkia Kamëz, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

a. Për vitin 2023 nga Bashkia Kamëz janë shpenzuar gjithsej 4,211,735 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 928,368 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 356,656 mijë lekë; për investime në vlerën 2,797,526 mijë lekë.

b. Për vitin 2023 Bashkia Kamëz nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 1,808,971 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” neni 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kamëz si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 46,504 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar gjetje 19 dhe ka dhënë 20 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me Kodin e Etikës dhe Rregulloren e Bashkisë Kamzë. Mungojnë raportimet periodike nga një pjesë e drejtorive, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Bashkia Kamzë nuk ka hartuar Planin e Veprimit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2023. Bashkia Kamzë, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1, 3.3, Kreu II kap. 2.2.6.

- Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 2,218,217 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 1,808,971 mijë lekë ose në masën 81.55% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 409,245 mijë lekë.

Referuar vlerës 409,245 mijë lekë të mosrealizimit disa prej zërave fiskal të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë

-“Taksë ndërtese biznes” është planifikuar në vlerën 77,250 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 55,056 mijë lekë ose realizuar në masën 71%.

- Taksë e gjelbërt biznes” është planifikuar në vlerën 18,401 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 677 mijë lekë ose realizuar në masën 3.68 %.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

-“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 24,684 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 40,203 mijë lekë ose realizuar në masën 162%.

Tarifë pastrim mbetjesh biznes” është planifikuar në vlerën 85,149 mijë lekë ndërsa arkëtimet në vlerën 101,848 mijë lekë ose realizuar në masën 119%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200.

- Nga auditimi rezulton se totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2023 është në vlerën 373,927 mijë lekë. Nga këto detyrimet të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta janë në vlerën 137,904 mijë lekë dhe detyrimet të prapambetura nga Buxheti i Shtetit janë në vlerën 236,023 mijë lekë. Detyrimet e prapambetura nga të ardhurat e veta janë të klasifikuara si më poshtë:

1-Investime në shumën 88,072,528 lekë e cila i përket 12 projekteve të investimit.

2-Fatura shërbime në shumën 43,712,342 lekë i përket shërbimit të pastrimit të qytetit.

3- Fatura mallra në shumën 6,120,000 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë kontabilizuar 14 aktive me certifikatë pronësie por pa vlerë kontabël në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore,

në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe në kundërshtim me SKK 5 “ Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale i përmirësuar” pika 8.

- Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 llogaria 212 është shtuar në vlerën 1,003,472,962 lekë për 14 projekte investimi.

Referuar auditimit të projekteve të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, kontabilizimi nuk është kryer në përputhje me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, për çdo projekt disponohej situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi por nuk disponohej dokumentacioni i pronësisë së aktiveve.

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Gjatë vitit 2023 llogaria 213 është shtuar në vlerën 2,841,437,423 lekë për 97 projekte investimi Referuar auditimit të projekteve të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për çdo projekt disponohej situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi por nuk disponohej dokumentacioni i pronësisë së aktiveve.

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se gjatë periudhës 2011-2022 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet VKM-ve në Bashkinë Kamëz janë transferuar 1,352 pasuri nga këto 548 pasuri në pronësi dhe 806 pasuri në përdorim. Në Bashkinë Kamëz me VKM nr. 775, datë 05.09.2013 janë transferuar 1087 pasuri nga këto 440 pasuri në pronësi dhe 647 pasuri në përdorim, me VKM nr. 16, datë 13.01.2022 janë transferuar pasuri.

Në NjA Paskuqan me VKM nr.454, datë 22.06.2011 janë transferuar 265 pasuri nga këto 106 pasuri në pronësi dhe 159 pasuri në përdorim.

Nga pasuritë e transferuara 50 pasuri janë pajisur me certifikatë pronësie, 806 pasuri janë të pajisura me certifikatë përdorimi dhe 498 pasuri nuk janë pajisur me certifikatë pronësie. Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Kadastrës, Bashkia Kamëz ka dërguar për regjistrim 13 praktika për regjistrim dhe 3 kërkesa për status juridik. . Veprime këto në kundërshtim me nenin 37 i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

- Nga auditimi u konstatua se detyrimet e abonentëve privatë nga taksat dhe tarifat vendore që kanë ndaj Bashkisë Kamëz deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor ka qenë në vlerën 85,866,370 lekë për 395 abonentë privatë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 7,508,243 lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 48,627,106 lekë për 200 subjekte. Borxhi tatimor për abonentët privatë është i kontabilizuar.Vlera progresive në datë 31.12.2023 është në vlerën 126,985,233 lekë për 595 abonentë privatë.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se në territorin e Bashkisë Kamëz për vitin ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitetin 42 subjekte të cilat tregtojnë

me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatua se gjatë vitit 2023, 21 subjekte kanë rinovuar licencën. Gjatë vitit 2023, 18 subjekte janë pajisur me licencë me afat 1 vjeçar për të cilët është përlogaritur detyrimi 202,000 lekë në kundërshtim me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9.

Gjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë së Kamzës ka operuar 14 subjekte me aktivitet tregtimin me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve pa u pajisur me autorizim përkatës nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit. Drejtoria e Licencave dhe Transportit gjatë vitit 2023 ka lejuar veprimtarinë e 14 subjekteve pa autorizim përkatës në kundërshtim me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 15.1 nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit këto subjekte janë ngarkuar me detyrim vjetor, duke mos pastur autorizim për këto subjekte nuk lind detyrim tatimor por këto subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizim duhet vepruar sipas VKM së mësipërme. Vetëm subjektet të cilat pajisen me autorizim ju lind detyrim tatimor.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, dhe Koordinatorin e MFK -së të marrin masa për: Hartimin e planeve të trajnimit për njohjen e punonjësve lidhur me bazën rregullatore të Bashkisë dhe Kodin Etik, hartimin e planeve vjetor për trajnimet e brendshme për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të Bashkisë, hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit gjithëpërfshirëse, si dhe hartimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm.

- Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa që të arkivojë dosjet e auditimit të realizuara dhe të ndjekë këtë praktikë në përfundim të auditimeve në të ardhmen.

- Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

- Kryetari i Bashkisë Kamëz dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

- Drejtoria e Financës dhe e Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, të marrë masat e nevojshme të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen në dorëzim të objekteve të likuidimin e detyrimeve bazuar në kushtet e kontratës.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që:

Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të kryej parashikime bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

- Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që, të plotësojë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosjet e subjekteve si biznes i madh dhe i vogël me qëllim përlogaritjen e saktë të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore.

-Ndryshimet në sistem në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të shoqërohen me dokumentacion vërtetues, të mbahen procesverbalet e ndryshimit në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note). Të kryhet monitorimi dhe dokumentimi i rakordimeve midis informacionit nga sistemi dhe procesit të popullimit të bazës së të dhënave.

- Drejtori e Financës dhe e Kontabilitetit të marrë masa për kontabilizimin e aktiveve në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” me vlerë të drejtë.

- Bashkia Kamëz, Drejtoria e Projekteve dhe Investime, Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të aseteve të marrë masa për hipotekimin e aseteve përpara kryesjes së investimeve kapitale.

- Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, të marrë masa për të bërë sistemin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

- Kryetari i Bashkisë të marri masat që Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve të vazhdojë procesin e certifikimit të pasurive publike të cilat kanë kaluar në pronësi sipas VKM-ve përkatëse.

- Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2023, në vlerën totale 126,985,233 lekë.

- Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë detyrimi 312,233,577 lekë ndaj 9,087 personave.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për drejtimin e Bashkisë Kamëz mbi auditimin e pasqyrave financiare:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Kamëz për vitin ushtrimor 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të konsoliduara të subjektit Bashkia Kamëz janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga

subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 10,682 mijë lekë.

Përshtetja kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë: Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

- Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë kontabilizuar 14 aktive me certifikatë pronësie jo me vlerë të drejtë.

- Në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie 14 asete me vlerë 1,003,472,962 lekë të cilat janë projekte investimi të përfunduara.

- Në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie 97 asete me vlerë 2,841,437,423 lekë të cilat janë projekte investimi të përfunduara.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1085/1 prot., datë 12.09.2024 “Auditim financiar në Bashkinë Kamëz”, i ndryshuar me nr. 1085/2 prot., datë 09.10.2024 të miratuar nga Kryetari KLSH-së, me afat auditimi nga data 12.09.2024 deri më 18.10.2024, në subjektin Bashkia Kamëz për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K. H, *Auditues i parë, Përgjegjës Grupi,*
2. K. F, *Audituese e parë, anëtare;*
3. L. L, *Audituese e parë, anëtare;*
4. M. M, *Auditues i parë, anëtar*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së

një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet raporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kamëz.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kamëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit të gjykit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kamëz.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Kamëz (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Kamëz, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar në aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet

buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shpreh një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kamëz është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit e pronës publike: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të Bashkisë”.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar i Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH-së me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin². Nisur nga gjykimin dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

² ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimin profesional i audituesit.

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Projekt Raportit të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm- Bashkia Kamëz është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave. Bashkia ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, në veriperëndim të saj. Kufizohet në veri me Kamzën, në jug me Tiranën, në lindje me Zall-Herrin dhe në perëndim me Bërxullin. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit. Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbret në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit. Bashkia ndodhet në trekëndëshin strategjik: kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit. Bashkia Kamëz ka një sipërfaqe prej 37.18 km², popullsia është 133,499 banorë dhe ka dy njësi administrative: Bashkia pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Kamëz, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Kamëz për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

2.1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1: *“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.*

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

-Nga auditimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësonin e vetëvlerësimit si dhe dokumentacionit justifikues mbi të dhënat e paraqitura në pyetësor, konstatohet se institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 4119 prot., datë 11.05.2022 “Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

-Kodi i Etikës është miratuar si një shtesë e rregullores së brendshme, në mbështetje të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me Kodin e Etikës apo Rregulloren e Bashkisë Kamëz.

-Me shkresën nr. 154 prot., datë 11.01.2019 është miratuar “Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kufidencialitetit në Bashkinë Kamëz” dhe “Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen në Bashkinë Kamëz”.

-Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore, bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.

-Kryhen dy vlerësime gjatë vitit kalendarik, vetëm për nëpunësit civil në periudhë prove vlerësimi është një vjeçar në përfundim të periudhës së provës.

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

Në lidhje me parimin nr. 2: *“Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.*

-Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2023, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga një pjesë e drejtorive, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.

-Bashkia Kamëz ka hartuar raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si edhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se për vitin 2023, Bashkia Kamëz nuk ka hartuar Planin e Veprimit të Kontrollit të Brendshëm në kundërshtim me paragrafin 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH-ja nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrësi qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Në lidhje me parimin nr.3: “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

-Dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023-2025 është miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kamëz me vendimin nr. 163, të datës 21.12.2022.

-Nga auditimi rezulton se lidhur me strukturën organizative, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kamëz ka miratuar strukturën organizative për vitin 2023 me VKB nr. 164, datë 21.12.2022

-Bashkia Kamëz ka gjithsej 504 punonjës. Punonjësit me status nëpunësi civil dhe kontratë si dhe vendet vakante për vitin 2023 paraqiten si më poshtë.

Tabela 1: Punonjësit me status nëpunësi civil dhe kontratë si dhe vendet vakante për vitin 2023

	Nëpunës Civilë	130
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	Nëpunës me kontratë	194
A ka punonjës me kontratë provizore? (PO/JO)	Nëse po, sa?	6 (zëvendësues të lejeve të lindjeve)
A janë të plotësuar vendet vakante (PO/JO)	Nëse jo, sa vende vakante ka?	9 vende vakante

Burimi: Bashkia Kamëz

Për vitin 2023 rekrutimet dhe largimet nga puna paraqiten në **aneksin nr. 1/1 dhe aneksin nr.1/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

-Bashkia Kamëz ka miratuar planin 5-vjeçar për strehimin social me VKB nr. 14 datë 15.07.2022. Plani rregullues i bashkisë është miratuar me VKB nr. 86 datë 14.07.2022 dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01 datë 27.07.2022.

-Sipas intervistave me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik konfirmohet se janë organizuar takime me drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, si dhe janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjësive me publikun.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Kamëz, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Në materialet që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së konstatohen dokumente që vërtetojnë trajnimin e punonjësve nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ndërkaq Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1 parashikon se vetë institucioni duhet të organizojë trajnime të brendshme për stafin.

-Trajnimet realizohen nga ASPA dhe punonjësit i përzgjedhin vetë temat për të cilat kanë interes. Mos hartimi i planeve vjetore të trajnimeve nuk mundëson një trajnim efektiv të personelit në përputhje me pozicionin në strukturë. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Për sa më sipër, përgjegjësia i takon znj. R.H me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Manualin për MFK, paragrafi 3.1.

-Për Bashkinë Kamëz Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

-Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Financës.

-Me Urdhrin nr. 244 datë 11.03.2023, titullari ka emëruar në rolin e Koordinatorës së MFK, znj. R.B.

-Me Urdhrin nr. 636 datë 31.10.2023, Titullari i Bashkisë Kamëz ka krijuar ekipin e koordinatorëve të riskut për çdo nivel drejtimi.

-Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

-Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 152 datë 07.02.2022 është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik. Përbërja e këtij grupi ka ndryshuar me Urdhrin nr. 437, datë 18.01.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se në vitin 2023 janë mbajtur 4 takime në përputhje me përcaktimet ligjore.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga auditimi i të dhënave, duke marrë në konsideratë se bashkia duhet të specifikojë dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur PBA, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Nuk janë krijuar në mënyrë të plotë mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Nga Bashkia Kamëz nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, si dhe Udhëzimi nr.16 dt. 20.07.2016.

-Me Vendimin nr. 105 datë 1.02.2022 “Mbi miratimin e strategjisë së riskut” Kryetari i Bashkisë Kamëz ka miratuar regjistrin e riskut.

-Nga auditimi rezulton se, gjurma standarde e auditimit është miratuar me Vendimin nr. 46 datë 19.01.2023.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Kamëz nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

-Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar.

-Bashkia Kamëz ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se hartë dhe manual të proceseve të punës ka vetëm një prej drejtorive të bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit. Manuali i proceseve të punës është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 283/1 prot., datë 14.01.2022, harta e proceseve të punës miratuar me shkresën nr. 284/2 prot., datë 14.01.2022.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Përgjegjësi i Buxhetit. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Specialisti i financës për kontabilizimin dhe autorizimi i pagesës nga Drejtori i Financës.

-Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

-Bashkia Kamëz ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Nëpërmjet VKB nr. 36 datë 20.03.2020 është miratuar rregullorja e menaxhimit të aktiveve.

-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikën e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Kamëz.

-Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollat e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

-Bashkia Kamëz ka një server për menaxhimin e sistemit të taksave të shtrirë edhe në Njësitë Administrative. Ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it, procedurë që e realizojnë nëpërmjet prokurimit të shërbimit me kontratë me kompaninë Besimes Informon Systems Softëare, Institucioni përdor edhe sisteme të tjera të It-së si E-Lejet, sistemin e zyrës me një ndalesë, sistemin e pagesave me thesarin. Me aktin nr. 76/1 prot., datë 08.02.2021 është miratuar rregullore e brendshme e IT.

-Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-Bashkia i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Me Vendimin nr. 36 datë 20.03.2020, Bashkia Kamëz ka miratuar rregulloren “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktivëve, inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivëve, dhe strategjinë e menaxhimit të riskut të aktivëve në Bashkinë Kamëz.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas programeve dhe projekteve.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

-Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas programeve dhe projekteve. Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.

-Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.

-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

-Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.

-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit.

-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

-Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Raportohet mbi baza periodike pranë MFE dhe GMS për veprimtarinë financiare referuar parashikimeve të PBA-së.

-Bashkia Kamëz monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 1732/1 prot., datë 20.02.2024 në Drejtorinë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.

- Bashkia Kamëz nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë bashki.

-Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

-NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2023.

Në lidhje me parimin 17: “Njëësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

-Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH-ja ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçanta për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me: Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1, 3.3, Kreu II kap. 2.2.6,

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. R.B, me detyrë Drejtor i Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e kordinatorit të MFK, për *veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në kundërshtim me: Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1, 3.3, Kreu II kap. 2.2.6,*

2. Znj. R.H, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore, për *veprimet në kundërshtim me, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin paragrafi 3.1.*

Për sa trajtuar në Projekt Raportit e Auditimit dërguar me shkresë 1085/4, datë 16.12.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1 prot., datë 15.01.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/3 prot., datë 20.01.2025, nga znj. R. H, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1.Pretendimi i subjektit:

Pasi u njohëm me projekt raportin me nr.1085 prot, datë 16.12.2024, ju sqarojmë si mëposhtë:

-Janë hartuar programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës. Kodi i etikës i Bashkisë ju është përcjell në rrugë zyrtare të gjithë strukturave (drejtorive, sektorëve, njësive administrative).

Bazuar në rregulloren e brendshme çdo drejtori harton përshkrimet e punës të cilat nënshkruhen nga çdo punonjës. Me shkresën nr.8993 prot., datë 23.11.2023 i është kërkuar shkollës shqiptare të administratës publike planifikimi për trajnimin e punonjësve (trajnimi i detyrueshëm) pa të cilin nuk ju jepet konfirmimi si nëpunës civil.

Trajnimet e shkollës shqiptare të administratës publike janë njoftuar dhe janë ndjekur nga punonjësit sipas temave përkatëse.

-Raportimet periodike janë hartuar nga të gjitha drejtoritë. Raportet e monitorimit janë mbi bazën e programeve buxhetore ku çdo menaxher programi raporton për treguesit dhe realizimin bazuar në objektivat që ka. Raportet e monitorimit hartohen dhe nënshkruhen nga të gjithë menaxherët e programve.Gjithashtu nga çdo punonjës në nivel drejtues raportohet në mbledhjet që zhvillohen.

Drejtoritë kanë hartuar raportet vjetore të punës (bashkëngjitur në observacionin e mësipërm raporti vjetor i punës për drejtorinë e ndihmës ekonomike dhe drejtorinë e emergjencave civile dhe strehimit.

-Plani i veprimit i kontrollit të brendshëm është hartuar dhe është pjesë e pyetësorit të KBFP dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1732/1, datë 28.02.2024, (bashkëngjitur në observacionin e mësipërm).

1.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Bashkia Kamëz në lidhje me planin e veprimit të kontrollit të brendshëm nga Bashkia Kamëz citohet se ky plan është hartuar dhe është pjesë e pyetësorit të KBFP dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1732/1, datë 28.02.2024, por ky plan nuk është bashkëngjitur në observacionin e dërguar me shkresën 532/1 prot., datë 15.01.2024.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

2.Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Bashkia Kamëz për trajnimin e punonjësve të institucionit, nuk janë paraqitur argumenta dhe dokumentacion shtesë. Trajtimi është i njëjtë si në projekt raportin e auditimit të dërguar me shkresë 1085/4, datë 16.12.2024. Institucioni duhet të hartojë trajnime të brendshme të stafit për rritjen e aftësive profesionale.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Bashkia Kamëz në lidhje me trajnimin e punonjësve të institucionit, nuk janë paraqitur argumenta dhe dokumentacion shtesë trajtimi është i njëjtë si në projekt raportin e auditimit të dërguar me shkresë 1085/4, datë 16.12.2024. Institucioni duhet të hartojë trajnime të brendshme të stafit për rritjen e aftësive profesionale.

4. Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Bashkia Kamëz në lidhje me mungesën e raportimeve periodike nga një pjesë e drejtorive, u konstatua se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka dërguar kopje të raportimeve periodike të njësive dhe drejtorive si: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Cështjeve Sociale (raportim për vitin 2023), Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kamëz, u konstatua se mungojnë datat e dërgimit të këtyre materialeve, si dhe firmat konfirmuese të drejtuesve të njësive që dërgojnë dhe marrin informacionin periodik. Për sa më sipër nuk mund të provohet që këto materiale janë dërguar përgjatë vitit ushtrimor 2023. Nuk dokumentohen raporte periodike të njësive apo drejtorive të tjera pjesë të Organigramës së Bashkisë Kamëz.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Në zbatim të nënpikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësive të auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Struktura e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Kamëz, për vitin 2023, funksionon në nivel drejtorie, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 163 datë 21.12.2022 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2023, 2024, 2025” si dhe vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 5 prot., datë 05.01.2023. Për sa më sipër është vepruar në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si dhe në përputhje me Standardin Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm. Për vitin 2023, kjo Drejtoria ka funksionuar në pjesën më të madhe të vitit 2023 me 6 punonjës në strukturë. Drejtor i kësaj Drejtorie është znj. B. D.

Struktura e Drejtorisë AB për vitin 2023 paraqitet në **aneksin nr. 1/3** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për periudhën 2023.

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, nga DAB pranë Bashkisë Kamëz, janë kryer 8 auditime, miratuar me planin vjetor të punës me urdhërin nr. 9433, datë 14.10.2022 ndryshuar me shkresën dërguar MFE me nr. 7863, datë 18.10.2022.

Raportimi për auditimet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2023 paraqitet në **aneksin nr. 1/4** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Plani Strategjik 2023-2025 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.9433 datë 14.10.2022.

Për aktivitetin e veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.1332 datë 14.02.2024.

-Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Kamëz me shkresën nr.8823 prot., datë 30.09.2022.

-Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, rezulton se janë dhënë 46 rekomandime, nga të cilat janë pranuar të gjitha. Nga 46 rekomandime janë zbatuar 24 rekomandime, ndërkohë janë në proces zbatimi 22 rekomandime.

Tabela përmbledhëse për auditimet e kryera gjatë vitit 2023 paraqitet në **aneksi nr.1/5** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Bashkia Kamzë ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Nga materialet e vendosura në dispozicion, raporti dërguar Kryetarit të Bashkisë Kamzë, dhe procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluar nga ky organ, rezulton se përbërja dhe veprimtaria e Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka qenë në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe me VKM nr. 160/2016, “Për mënyrat e Funksionimit, Kompetencat dhe Përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

-Me Vendimin nr. 8823, datë 30.09.2022, Kryetari i Bashkisë Kamzë, ka miratuar Kartën e Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Kamzë. Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”;

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull:

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, ka qenë në përputhje me urdhërin nr. 4, datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me nenin 19 të Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

-Për vitin 2023, konstatohet se janë realizuar 8 auditime: Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve 2022, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Licensave dhe Transportit, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe IT, Drejtoria e MPTM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit, Ujësjellës Kamza SHA, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

-Materialet e auditimit janë hartuar në përputhje me standardet dhe përcaktimet e Manualit të Auditit të Brendshëm

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelet e fonde të çelura.

2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

2.2.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

2.2.6 Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien më qera të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2023-2025 auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Tiranë për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj).
9. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

2.2.1 Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor

Bashkia Kamëz për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar buxhetin në zbatim të kërkesave:

Për vitin 2023 buxheti i Bashkisë Kamëz është miratuar me VKB nr.163 datë 21.12.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023”, me VKB nr. 22 datë 17.03.2023 “Për miratimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022”, me VKB nr. 94 datë 19.07.2022 “Për miratimin tavanëve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Kamëz ”. Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2023 me VKB nr. 163 datë 21.12.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023” është bërë brenda afateve ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet:

Përgatitja dhe miratimi i buxhetëve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetët në këshillat e tyre. Këshilli brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

Programimi buxhetor afatmesëm i Bashkisë Kamëz parashikon një mbulim sa me të plotë të territorit me shërbime publike cilësore, me qëllim përmirësimin e jetës së komunitetit, përmirësimin dhe modernizimin të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, përmirësimin e pastrimit qytetit, rritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve, zhvillimin e turizmit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, mbulimin e territorit me shërbime sociale, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, menaxhimin e situatave natyrore, etj.

Bashkia Kamëz administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve miratuara 2023-2025:

Programi i planifikim-menaxhim-administrim	Program Planifikimi Urban Vendore
Programi i shërbimit policisë vendore	Program Shërbimet Publike Vendore
Programi i mbrojtjes nga zjarri e civile	Program Furnizimi me uje dhe kanalizime
Programi i mbështetjes për zhvillim ekonomik	Program Sport dhe Argëtim
Programi shërbimeve bujqësore,	Program i Kulturës
Programi menaxhimit të infrastrukturës ujëtare	Program arsimi, parauniversitar
Programi i administrimit të pyjeve dhe kullotave	Program arsimi mesëm i përgjithshëm
Programi i Rrjeti Rrugor Rural	Programi i përkujdesi social
Programi menaxhimit të mbetjeve,	Programi i strehimit social

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Programimi i PBA 2023-2025 parashikon burimet e financimit që janë:

-Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat vendore, nga të ardhurat tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen.

-Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuara, transferta specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar bashkisë dhe transferta e kushtëzuara.

Është bërë miratimi i tavanëve të buxhetit afatmesëm 2023-2025 me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 35 datë 11.03.2022 “Për miratimin e tavanëve dhe pasqyrave të programimit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, sipas kërkesave ligjit 68/2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, neni 37. Disponohet ky VKB “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Kamëz për vitet 2023-2025”, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Këshilli Bashkiak Kamëz ka marrë vendim për miratimin e kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, sipas VKB nr. 127 datë 17.12.2021.

Është ngritur Grupi prej 23 punonjës, për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, me urdhër të Titullarit të Bashkisë nr. 152 datë 07.02.2022 si dhe 11 Ekiye të Menaxhimit të Programeve .

Disponohet Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen afati, personat përgjegjës, bazuar në udhëzimin e brendshëm të titullarit njësisë vendore nr. 2167, datë 16.03.2022.

Mbledhjet e GMS janë të dokumentuara. Këto mbledhje janë mbajtur për të diskutuar rreth planifikimit, monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve tjera menaxhimit financiar e kontrollit. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA e viteve të mëparshme dhe mbi një analizë të mirëfilltë. Bashkia Kamëz është mbështetur në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, konkretisht sipas neneve, 33, 34, 35, 36, 37, dhe në Udhëzimet nr.8 datë 28.02.2022 dhe nr.23, datë 08.07.2022 “Për procedurat standarde përgatitjes PBA njësisë vendore”. Disponohet dokumentacioni për dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit, sipas protokollit të mbajtur me datë 27.09.2022, datë 12.10.2022 dhe 26.10.2022. Gjithashtu është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujorë gjatë vitit 2023. Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore, sipas kërkesave të shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe shtojcës 5 "Treguesit monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të UMFE 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisë vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit për çdo 4-mujor të vitit 2023 janë të plota me të gjitha anekset, sipas kërkesave të ligjit nr.68/2017 "Për Financat Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr.22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisë vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48. Dokumenti i PBA 2023-2025 nga Bashkia Kamëz është dërguar pranë Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Financave Vendore, sipas shkresave nr. 4197, datë 22.05.2023, nr. 6910 datë 29.09.2023 dhe nr.1537, datë 20.02.2024 “Dërgim raporti monitorimi për 4-mujorin I, II dhe III 2023”. Bazuar në Raportin e monitorimit për 4-mujorin e III vitit 2023, rezulton se:

-Realizimi i të ardhurave për 12 mujorin e vitit 2023 paraqitet 81.55 % krahasuar me planin (fakt 1,808,972 dhe 2,218,217 plani),000/lekë.

Peshën më të madhe e zënë të ardhurat tatimore 72%, të ardhurat jo tatimore zënë 27.9% dhe të ndarë sipas llojit të të ardhurave, realizimi i të ardhurave është: të ardhura tatimore 80% (fakt 1,302,256,:1,620,943 plan)000/lekë,të ardhura jo tatimore zënë 85%(fakt 505,452,: 596,011plan)000/ lekë si dhe të ardhura nga sponsorizimet 100% (fakt 1,264: 1,264 plan) 000/lekë.

Dinamika e të ardhurave ndër vitë ka tendencë në rritje, konkretisht: viti 2019 paraqet 610,651 mijë lekë, viti 2020 paraqet 545,468 mijë lekë, viti 2021 paraqet 792,637 mijë lekë, viti 2022 paraqet 1,055,658 mijë lekë, dhe viti 2023 paraqet 1,808,972 mijë lekë.

-Realizimi i buxhetit për 12 mujorin e vitit 2023 paraqitet në masën 91% krahasuar me planin (plan 1,796,339 mijë lekë dhe 1,631,893 mijë lekë fakt), sipas artikujve paraqitet:

* Zëri “paga” (600) plan=922,634 mijë lekë, fakt=816,697 mijë lekë ose 88.52%,

* Zëri “sig.shoq.shend.”(601) plan=145,172 mijë lekë, fakt=128,079 mijë lekë ose 88.23%,

* Zëri “mallra e shërbime” (602) plan=536,813 mijë lekë, fakt=631,882 mijë lekë ose 67.41%,

* Zëri “transferta korent brend” (604) plan=46,416 mijë lekë, fakt=43,387 mijë lekë ose 93.47%,

*Zëri “transfertë për buxhetin familjar dhe individ” (606) plan=886,376 mijë lekë fakt=812,916 mijë lekë ose 91.71 %,

*Zëri “investime” (231) plan= 3,643,893 mijë lekë, fakti= 3,207,857 mijë lekë, realizimi është në masën 88.03%. Zëri i Investimeve zë peshën kryesore të totalit të shpenzimeve të buxhetit ose

59.73 % të buxhetit 2023 kjo tregon për një efektivitet në administrimin e fondeve buxhetore ku fokusi kryesor janë Investime dhe pjesën më të madhe e zë infrastruktura rrugore.

Me shkresën nr.1593 prot. datë 22.02.2022 është hartuar udhëzimi i brendshëm për përgatitjen e PBA 2023-2025.

Tabela nr. 1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Programi	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
			000/lekë	%	000/lekë	%	000/lekë	%
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	348,845	5.19%	378,282	7.70%	388,881	7.82%
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	29,502	0.44%	30,387	0.62%	31,298	0.63%
3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	90,781	1.35%	93,504	1.90%	96,310	1.94%
4	04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	21200	0.32%	21836	0.44%	22491	0.45%
5	04220	Shërb. Bujq., Insp., Sig. Ushq Mbr Kons.	7,441	0.11%	7,665	0.16%	7,894	0.16%
6	04240	Menaxhimi Infrastruk Ujitjes- Kullimit	4,885	0.07%	5,031	0.10%	5,182	0.10%
7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	3624	0.05%	3733	0.08%	3845	0.08%
8	04520	Rrjeti Rrugor Rural	1,435,462	21.34%	1,534,016	31.23%	1,580,568	31.80%
9	04570	Transporti Publik	11,065	0.16%	11,397	0.23%	11,739	0.24%
10	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	202,500	3.01%	135,000	2.75%	139,050	2.80%
11	06140	Planifikimi Urban Vendor	57,041	0.85%	58,752	1.20%	60,514	1.22%
12	06260	Shërbimet Publike Vendore	446,674	6.64%	330,268	6.72%	345,176	6.94%
13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	973,607	14.47%	497,349	10.12%	477,054	9.60%
14		Shërbimet e Kujdesit Parësor	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
15	08130	Sport dhe Argëtim	25,374	0.38%	26,135	0.53%	26,919	0.54%
16	08220	Trashëg. Kultur, Eventët Artistike Kult.	51,352	0.76%	52,892	1.08%	54,479	1.10%
17	09120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	1,748,676	26.00%	643,621	13.10%	625,215	12.58%
18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	198,562	2.95%	32,835	0.67%	33,820	0.68%
19	10430	Përkujdesi Social	713,297	10.60%	731,365	14.89%	746,004	15.01%
20	10661	Strehimi Social	350,159	5.21%	257,152	5.23%	251,207	5.05%
21	04910	Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës	6,665	0.10%	61,255	1.25%	63,112	1.27%
		Totali	6,726,712	100%	4,912,475	100%	4,970,758	100%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Tabela nr.2: Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	%total	000/lekë	% /total	000/lekë	% /tot
1	Paga (600)	827,733	12.31%	852,563	17.36%	878,141	17.67%
2	Sigurime (601)	132,910	1.98%	134,837	2.74%	138,879	2.79%
3	Shpenzime operative (602)	485,114	7.21%	432,124	8.80%	445,086	8.95%
4	Shpenzime (604)	14,738	0.22%	14,836	0.30%	15,280	0.31%
5	Shpenzime (606)	1,036,979	15.42%	957,366	19.49%	965,132	19.42%
6	Shpenzime (609)	6,665	0.10%	61,255	1.25%	63,112	1.27%
7	Shpenzime për investime (230-231)	4,222,574	62.77%	2,459,494	50.07%	2,465,128	49.59%
	Shuma	6,726,712	100%	4,912,475	100%	4,970,758	100%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Tabela nr.3: Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:
Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	1,570,832	1,650,166	1,701,170
2	Jo tatimore	593,889	613,072	620,847
I	Totali	2,164,721	2,263,238	2,322,017
1	Transferta e pakushtëzuar	631,797	694,977	729,726
2	Transferte specifike	356,534	367,230	378,247
II	Shuma e transfertave	988,331	1,062,207	1,107,973
1	Transferta Për funksione të deleguara	827,542	827,543	827,544
2	Transferta të pritshme (FZHR e tjera)	2,746,118	759,487	713,224
III	Shuma	3,573,660	1,587,030	1,540,768

Totali i burimeve të veta (I +II+III)	6,726,712	4,912,475	4,970,758
--	------------------	------------------	------------------

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Tabela nr. 4:Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Emërtimi	PBA 2023-2025		Buxheti 2023	
	Ardhura	Shpenzime	Ardhura	Shpenzime
Të ardhura të veta të trashëguara viti 2022			3,673	
Të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuara 2022			12,615	
Të trashëguara nga transfertat specifike 2022			27,581	
Të trashëguara nga transfertat Rindërtimi 2022			260,442	
Plani i të ardhurave viti ushtrimor (2023)	1,634,548		2,218,217	
Transferta e pakushtëzuara viti 2023	552,822		742,097	
Transferta specifike viti 2023	285,078		365,583	
Transfertë e pakushtëzuar viti 2023 Rindërtimi	1,700,000		1,416,919	
-Nga FZSH e Ministrisë e Linjës	1,004,398		410,608	
-Nga Ministrisë e Linjës	827,542		753,970	
Paga (600)		614,327		731,772
Sigurime shoqërore (601)		96,700		115,034
Shpenzime operative (602)		335,670		469,155
Transferta (606) Rindërtimi		82,000		78,236
Transferta (604+606+609) të ardhura+transfertë		154,400		153,185
Transferta (604+606+609) ministri e linjës		760,803		731,521
Investime (230+231) nga të ardhurat. Transfertë e Pakushtëzuar		1,308,329		1,601,590
Investime Rindërtimi		1,685,201		1,599,125
Investime nga FZHR e Ministrisë e linjës		966,958		410,608
Të tjera (166,651,603,604,606) dy ndërmarrjet e varesise				321,479
Totali	6,004,388	6,004,388	6,211,705	6,211,705

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Të dhënat në tabelë janë për aparatën e Bashkisë Kamëz së bashku me njësitë administrative dhe njësitë vartëse.

-Referuar të dhënave të pasqyres, konstatohet se Bashkia Kamëz ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 27.22 % të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023. Ndërkohë që nga tabela rezulton se fondet e trashëguara nga viti paraardhës janë 304,310,664 lekë, të ndara respektivisht: nga “të ardhurat e veta” 3,673,324 lekë, nga “transferta e pakushtëzuar” 12,614,790 lekë, nga “transferta specifike” 27,580,952 lekë, “transferta e rindërtimit” 260,441,598 lekë:

Tabela nr.5 :Burimet e financimit:

000/lekë

Nr.	Burimet e Financimit	Viti 2023	
		Plan	Fakt
1	Transferta e pakushtëzuar	754,711	738,788
2	Të ardhurat e veta	2,221,891	1,770,065
3	Transferta specifike, sektoriale	393,164	373,473
4	Fondet e rindërtimit	1,677,361	1,329,409
5	Fondet e kushtëzuara	1,164,578	1,159,084
	Totali	6,211,704	5,370,819

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Nga verifikimi dhe të dhënat e pasqyruara në tabelë rezultoi se shpenzimet me burim të “transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta” nga taksat e tarifave vendore janë planifikuar: për vitin 2023 në vlerën 2,976,602 mijë lekë; në fakt janë përdorur në vlerën 2,545,956 mijë lekë ose 85.53%. Fondet “specifike dhe sektoriale” janë planifikuar 393,164 mijë lekë dhe janë shpenzuar 336,370 mijë lekë ose 85.55%. Fondet e kushtëzuara janë planifikuar 1,164,578 mijë lekë dhe janë përdorur në masë të plotë 1,159,084 mijë lekë ose 99.53%, si dhe nga fondet e rindërtimit janë planifikuar 1,677,361 mijë lekë dhe janë përdorur 1,329,409 mijë lekë ose 79.26%. Ndërsa buxheti fillestar

për vitin 2023 është planifikuar në vlerën e 2,398,002 mijë lekë ku përfshihen: shpenzime korrente, kapitale, fond rezerve dhe kontigjence, transfertat sektoriale dhe me fondet e trashëguara nga viti 2022, me fondet e kushtëzuara dhe funksionet e deleguara arrin në vlerën e (plani progresiv) 6,211,704 mijë lekë dhe realizimi i tij në vlerën e 5,370,819 mijë lekë. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit, e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet. Nga auditimi rezulton se janë bërë aktrakordimet me thesarin dhe nuk rezultojnë diferenca. Tabela e shpenzimeve sipas programeve paraqitet në **aneksin nr. 2/1/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Tabela nr. 6: Treguesit buxhetor 2023 dhe mbulimi i tyre nga të ardhurat e veta, grandit dhe transferat e pakushtëzuar specifike.

Nr	Emërtimi	Viti 2023 ne 000/lekë						
		Plani fillim	Çelja në	Fakti sipas	Të ardhurat	Trans.	Trans.	Trans.
		Sipas VKB	Thesarit sipas akt rakordim	aktrakordimit	veta	pakusht	pakusht sektoriale	pakusht Rindërtim
1	Paga (600)	907,273	815,459	801,631	300,917	216,127	284,586,874	-
2	Sigurime (601)	143,822	132,147	126,737	49,692	32,109	44,936,010	-
3	Shpenzime (602)	531,076	381,170	356,656	242,054	71,782	42,820,611	-
4	Shpenzime (604)	14,738	11,710	11,710	11,710	-	-	-
5	Transferta (606)	186,533	128,346	117,475	45,565	2,690	382,250	68,837
6	(609) F. Rezervë	30,400	-	-	-	-	-	-
	Total	1,813,841	1,468,832	1,414,209	649,938	322,708	372,725,745	68,837
7	Inv(230 +231)	3,233,285	3,150,469	2,797,526	1,120,127	416,079	747,600	1,260,572
	Totali	5,047,127	4,619,301	4,211,735	1,770,065	738,788	373,473,345	1,329,409

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Sipas pasqyrës së mësipërme rezulton se peshën më të madhe e zënë investimet në infrastrukturë prej 2,797,526 mijë lekë, ose 66% të totalit të shpenzimeve të realizuar nga fondet që miratohen në këshillin bashkiak. Tek kjo shumë investimesh janë përfshirë dhe investimet nga rindërtimi ku janë në shumën 1,260,572 mijë lekë përkatësisht këtu përfshihen: rindërtim dhe rikonstrukcioni shkollave dhe kopshteve. Shpërndarja e fondeve të bashkisë (të ardhura dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale) është: Investimet zënë 53.32%, Pagat dhe sigurimet shoqërore (llog 600, llog 601), zënë 32.21% dhe shpenzimet operative dhe ndihmat sociale (llog 602, llog 604, llog 606) zënë 14.47%. Tek % që zënë shpenzimet për paga rreth 12% zënë shpenzimet për paga nga transfertat sektoriale. Kjo tregon një menaxhimi të mirë të shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike. Kjo nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative. Për llogarinë 606 “transferta” rezulton se për vitin 2023, fakti sipas rakordimeve është në vlerën 117,475 lekë, ku për transfertat e pakushtëzuara “Rindërtim” është në vlerën 68,837 lekë, ndërsa për transfertat e tjera rezulton në vlerën 48,487 lekë duke përfshirë:

- 1-Bonus strehimi në vlerën 28,724 lekë.
- 2-Ndihmë e familjeve në nevojë në vlerën 7,984 lekë.
- 3-Mbështetje për nxënësit ekselente në vlerën 8,676 lekë.

4-Fatkeqësi (banesave) në vlerën 2,890 lekë.

5-Daljet në pension (punonjësit) në vlerën 212,250 lekë.

Tabela nr. 7: Treguesit buxhetor 2023 dhe mbulimi i tyre nga transferta e kushtëzuara (funksione të deleguara), transferta kushtëzuara për investime.

Emërtimi	Viti 2023 ne 000/lekë			
	Çelja në thesarit sipas akt rakordimit Plan	Fakti sipas aktrakordimit Fakt	Tran. Kushtëzuar Funk Deleg.	Tran. Kushtëzuar Për investime
Paga (600)	15,362	15,066	15,066	
Sigur. (601)	1,350	1,343	1,343	
Shpenz (602)	5,737	5,226	5,226	
Shpenz (604)	31,678	31,677	31,677	
(609) Fond. Rezervë	-	-	-	
Transferta 606	699,843	695,442	695,442	
Total	753,970	748,753	748,753	-
Inv(230 +231)	410,608	410,331		410,331
Shuma Investime	410,608	410,331	-	410,331
Totali	1,164,578	1,159,084	748,753	410,331

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit.

Sipas pasqyrës së mësipërme investimet nga transferta e kushtëzuara janë në shumën 410,331 mijë lekë nga këto rezultojn se peshën më të madhe e zënë:

1. Investimet në infrastrukturë rrugore ujësjellës kanalizime në shumën prej 394,407 mijë lekë, përkatësisht: Ujësjellës dhe Kanalizime., konkretisht Ndërtim Rrjeti KUZ dhe furnizim me ujë i zonës Valias i ri, Ndërtim Rrjeti ujësjellës në zonën Fushë Kamëz si dhe mbikqyrës.
2. Pajisje mobilerie për shkollën Demokracia 8,288 mijë lekë.
3. Investimet Rikonstrukcion bibliotekë bashkë për një rini aktive 7,636 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve prej 5,370,819 mijë lekë, me burim financimi të gjitha llojet e transfertave, sipas situacionit vjetor të rakorduar me thesarin, paraqitet:

- Transferta e pakushtëzuar 738,788 mijë lekë fakti nga 754,711 mijë lekë plani ose 98 %,
- Transferta sektoriale 373,473 mijë lekë fakti nga 393,164 mijë lekë plani ose 95 %,
- Të ardhurat vendore 1,770,065 mijë lekë fakti nga 2,218,217 mijë lekë plani ose 66 %,
- Fondet e rindërtimit 1,329,409 mijë lekë fakti nga 1,669,132 mijë lekë plani ose 80 %
- Transfertat e kushtëzuara 1,159,084 lekë fakti nga 1,164,578 lekë plani ose 99.5 % ku:

Shpenzimet për paga llogaria 600 paraqiten për 816,696,675 lekë fakti nga 922,634,797 lekë plani ose 89 %.

Shpenzimet për sig. Shoq dhe shëndetësore paraqitën 128,079,340 lekë fakti nga 145,171,549 lekë plani ose 88 %.

Shpenzimet operative llogaria 602 paraqitën 361,882,465 lekë fakti nga 536,812,982 lekë plani ose 67 %.

Shpenzimet korentë llogaria 604 paraqitën 43,387,258 lekë fakti nga 46,416,292 lekë plani ose 93 %.

Shpenzimet korentë llogaria 606 paraqitën 812,916,456 lekë fakti nga 886,375,645 lekë plani ose 92 %.

Shpenzimet për investime llogaria 230 dhe 231 paraqitën 3,207,856,972 lekë fakti nga 3,643,893,159 lekë plani ose 88 %.

Transfertat e deleguara 1,159,084 mijë lekë fakti nga 1,164,578 mijë lekë plani ose 99.53 %, e cila sipas artikujve e zbërthyer pasqyrohet tek tabela nr.7. Transfertat e deleguar kanë përqindjen më të lartë prej 99.53% krahasuar me transferuat tjera, ndërsa peshën më të ulët e zënë të ardhurat vendore prej 77.4%. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga KB me

vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit buxhetit janë mbajtur tek llogaria thesarit, e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Disponohen akt-rakordimet periodike e vjetore me thesarin.

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2023 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Gjatë vitit 2023 buxheti ka pësuar ndryshime shtesa/pakesime, sipas VKB përkatëse.

2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Kamëz për PBA 2023-2025 dhe Projekt buxhetin e vitit 2023, ka zhvilluar takime për konsultime me grupet e interesit në komunitet, konform ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2023-2025 dhe projekt buxhetit vjetor 2023 nga ana e Bashkisë Kamëz, është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë:

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të 3 (tre) njësive administrative: Kamëz, Paskuqan dhe Bathore, të NSHP dhe NPGJT, si dhe gjithë njësive shpenzuese të strukture së Bashkisë. Drejtoria e Finances dhe e Kontabilitetit ka dërguar zyrtarisht shkresën për të paraqitur kërkesat e tyre buxhetore për të planifikuar shpenzimet për vitin në vijim.

Nga auditimi rezultoi se në PBA 2023-2025 dhe planin vjetor të buxhetit për vitin 2023, janë shprehur objektivat strategjike të Bashkisë, të cilat mbështetur në PPV, bëjnë planifikime buxhetore për ato programe të cilesuara si më prioritaret me projektet përkatëse. U konstatua se në PBA 2023-2025 dhe planin e buxhetit vjetor 2023 janë paraqitur projektet me keto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29.

-Për projektet e mëparshme të cilat kanë përfunduar dhe për arsye mos likuidimi, janë klasifikuar në statusin e “detyrimeve të prapambetura”.

-Me Udhëzimin e Brendshëm nr.2167 datë 16.03.2022 është hartuar plani i punës për përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Me Urdhrin nr. 438 datë 18.01.2023 është përditësuar GMS dhe krijuar 11 EMP, hartuar dhe plani vjetor i takimeve të GMS mbi ndjekjen e procesit të hartimit të PBA 2023-2025.

-PBA 2023-2025 dhe Buxheti vjetor për vitin 2023 kanë pësuar keto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

Tabela nr. 8: VKB e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit 2023

Nr .	VKB nr.dhe datë	Përshkrimi	Konfirmimi nga Prefekti
1	Nr. 35 datë 11.03.2022	Për miratimin e limitëve të PBA 2023, 2024, 2025	Nr. 477/2 datë 25.03.2022

2	Nr. 163 datë 21.12.2022	Për miratimin e buxhetit Për vitët 2023, 2024, 2025	Nr. 2387/1 datë 30.12.2022
3	Nr. 22 datë 17.03.2023	Për ndryshimin e VKB nr. 163 datë 21.12.2023	Nr. 465/1 datë 30.03.2023
4	Nr. 77 datë 01.08.2023	Për ndryshimin e VKB nr. 163 datë 21.12.2023	Nr. 1138/1 datë 14.08.2023
5	Nr. 84 datë 22.08.2023	Për ndryshimin e VKB nr. 163 datë 21.12.2023	Nr. 1277/1 datë 04.09.2023
6	Nr. 108 datë 18.12.2023	Për ndryshimin e VKB nr. 163 datë 21.12.2023	Nr. 1666/1 datë 20.12.2023
7	Nr. 118 datë 26.12.2023	Për ndryshimin e VKB nr. 163 datë 21.12.2023	Nr. 1686/1 datë 26.12.2023

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

VKB dhe lëvizjet e fondeve dhe të llogarive janë paraqitur në **aneksin nr. 2/1/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e Bashkisë për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitulli, artikulli e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me tabelat përkatëse, konform ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Planit vjetor 2023 dhe ndryshimeve e bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë informacione mbi burimin e financimit me argumentet e nevojshme mbi të cilat mbështeten këto ndryshime.

VKB-të e miratuara janë regjistruar në Regjistrin e protokollit;

VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Tiranë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë brenda afateve ligjore.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 i Bashkisë Kamëz paraqitet për vlerën 6,211,704 mijë lekë duke përfshirë:

1. Transferta e deleguar në shumën 753,970 mijë, transfertën e kushtëzuar për investime 410,608 mijë lekë.
2. Transferta e pakushtëzuar në shumën 754,711 mijë lekë.
3. Transferta sektoriale në shumën 393,164 mijë lekë.
4. Transferte e pakushtëzuar rindërtimi në shumën 1,669,132 mijë lekë.
5. Planifikimi i të ardhurave në shumën 2,218,217 mijë lekë.
6. Fonde që trashëgohen 11,902 mijë lekë.

Sipas tabelës nr.1 të buxhetit 2023 i miratuar në këshillin bashkiak, i ndarë:

- buxheti fillestar 3,206,548 mijë lekë,
- buxhet i trashëguar 304,311 mijë lekë,
- buxheti shtesë gjatë vitit 1,536,268 mijë lekë.

Ndërsa buxheti përfundimtar i programuar paraqitet për vlerën 5,047,127mijë lekë, e përbërë nga këto vlera (3,206,548 lekë + 304,311 lekë +1,536,268 lekë).

Analiza e shpenzimeve sipas artikujve 2023.

a. Shpenzimet për paga.

Shpenzimet për paga janë planifikuar për vlerën 922,635 mijë lekë dhe janë realizuar për vlerën 816,697 mijë lekë. Bashkia Kamëz për vitin 2023 ka gjithsej 1,088 punonjës fakti, nga këto:

-138 punonjës me status nëpunësit civil, ku marrëdhëniet e punës rregullohen sipas ligjit nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”.

-935 punonjës me kontratë pune, marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”.

-14 punonjës funksionar politik.

Organika e Bashkisë Kamëz për vitin 2023, sipas strukturës së miratuar, paraqitet sipas tabelës:

Për vitin 2023 bashkia (1 njësi administrative) bashkë me dy ndërmarrje varësie funksionon me një strukturë dhe organikë prej mesatarisht 1,088 punonjës fakti nga 1,116 punonjës plani. Me vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz nr.163, datë 21.12.2022, “Për miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitet 2023, 2024, 2025”, i ndryshuar është miratuar numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së bashkisë si dhe fondi i pagave, janë paraqitur për konfirmim dhe janë konfirmuar brenda afateve ligjore nga Prefektura e Qarkut Tirane, ku numri i punonjësve të aparatit të Bashkisë, ndërmarrjeve të varesise është:

Aparati	330 punonjës
Nd. Pastrim Gjellbërimit	162 punonjës
Nd. Shërbimeve Publike	98 punonjës
<u>Gjithsej</u>	590 punonjës

Numri i punonjësve në fillim të vitit nga transferta e pakushtëzuar sektoriale e ndarë sipas funksioneve:

Ujitja dhe kullimi	4 punonjës
Mbrojtja nga zjarri	49 punonjës
Qendra multifunksionale	12 punonjës
Personeli mësimor dhe jo mësimor A/parashkollor	347 punonjës
Personel në çerdhe	97 punonjës
Personeli ndihmës arsimit parauniversitar	17 punonjës
<u>Gjithsej</u>	526 punonjës

Për Përiudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, numri i punonjësve të Bashkisë Kamëz ka ndryshuar konkretisht: Me vendim të kryetarit të Bashkisë nr. 5 prot. datë 05.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”, i ndryshuar dhe nr. 12209 prot. datë 30.12.2022, i ndryshuar, është miratuar struktura organizative. Struktura është hartuar në përputhje me ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” me kërkesat e VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emruar, të nënpunesve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, (i ndryshuar), VKM nr. 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore” (VKM që ka shfuqizuar VKM nr.165 datë 02.03.2016 të ndryshuar).

-11 punonjës (1 kryetar, 3 zv/kryetar, dhe 5 këshilltarë kryetarit, 1 sekretar i këshillit, 1 specialist për çështjet juridike pranë KB).

- 5 punonjës Drejtoria e Auditit të Brendshëm (1 drejtor, 4 specialistë).

-17 punonjës paraqet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (1 drejtor, Sektori i Burimeve Njerëzore (1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 3 shofer administratë; Sektori i Protokollit (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë; Sektori i Arkivës (1 përgjegjës sektori); Sektori i statistikës (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë), Sektori i Administrimit të Sistemeve, IT-së (1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 sanitare).

-12 punonjës paraqet Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve, 1 drejtor, Sektori i investimeve dhe monitorimit të infrastruktures (1 përgjegjës sektori, 6 specialistë), Sektori i projektimit (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë).

-12 punonjës, paraqet Drejtoria, PKZH Tërritorit, 1 drejtor, Sektori i planifikimit të tërritorit (1 përgjegjës sektori, 4 specialistë), Sektori i kontrollit zhvillimit të tërritorit (1 përgjegjës sektori, 5 specialistë).

-8 punonjës, paraqet Drejtoria e Integritimit në BE dhe Projektëve të Huaja, 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.

-9 punonjës, paraqet Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile, 1 drejtor, Sektori i emergjencave civile (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë), sektori i strehimit (1 përgjegjës sektori, 4 specialistë).

-9 punonjës, paraqet Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

-9 punonjës, paraqet Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit, 1 drejtor, Sektori i kontabilitetit (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë), Sektori buxhetit dhe financës (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë), 1 arkëtar, 1 magazinier.

-23 punonjës, paraqet Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, 1 drejtor, Sektori i ndihmës ekonomike (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë), Sektori i PAK (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë), Sektori i mbrojtjes së femijëve (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë), Sektori i qendrës multifunksionale (1 përgjegjës sektori, 11 specialistë),

-15 punonjës, paraqet Drejtoria e Arsimit dhe Sportit, 1 drejtor, Sektori i arsimit dhe sportit (1 përgjegjës sektori, 8 specialistë), Sektori i arsimit parashkollor dhe ndihmes parauniversitar (1 përgjegjës sektori, 4 specialistë),

-9 punonjës, paraqet Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, 1 drejtor, Sektori i juridik (1 përgjegjës sektori, 4 specialistë), Sektori i prokurimeve publike (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë),

-9 punonjës, paraqet Drejtoria e Liçensave dhe Transportit, 1 drejtor, Sektori i Liçensave dhe Transportit (1 përgjegjës sektori, 7 specialistë),

-40 punonjës, paraqet Drejtoria e TTV, 1 drejtor, Sektori i terenit (1 përgjegjës sektori, 20 specialistë), Sektori i vleresimit të detyrimit dhe menaxhimit të borxhit (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë), Sektori i taksave familjare (1 përgjegjës sektori, 2 specialistë), Sektori i mbrojtjes së konsumatorit (1 përgjegjës sektori, 6 specialistë), Sektori i analizes dhe kontabilizimit të detyrimeve (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë),

-16 punonjës Drejtoria e Kadastres, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe menaxhimit të asetëve 1 drejtor, Sektori i kadastres (1 përgjegjës sektori, 5 specialistë); Sektori i bordit të kullimit (1 përgjegjës sektori, 4 specialistë); Sektori i Menaxhimit të asetëve (1 përgjegjës, 3 specialistë).

-19 punonjës Drejtoria e Medias dhe Marrëdhënieve me Publikun, 1 drejtor, Sektori i medias dhe informimit (1 përgjegjës sektori, 5 specialistë), Sektori i IT (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë), Sektori i shërbimeve administrative One Stop Shop (1 përgjegjës sektori, 7 specialistë),

-21 punonjës Drejtoria e Kulturës, Artit dhe Muzikës, 1 drejtor, Sektori i Kulturës, Artit dhe Muzikës (1 përgjegjës sektori, 19 specialistë).

-13 punonjës Njësia Administrative Lagjes Bathore, 1 administrator, 8 specialistë dhe 1 sanitare, Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe PAK (1 përgjegjës, 2 specialistë),

-6 punonjës Njësia Administrative Lagjia Nr. 1, 1 administrator (1 përgjegjës, 3 specialistë, 1 sanitare)

-7 punonjës Njësia Administrative Lagjia Nr. 2, 1 administrator (1 përgjegjës, 4 specialistë, 1 sanitare)

-15 punonjës Njësia Administrative Paskuqan, 1 administrator (1 përgjegjës, 4 specialistë), Sektori i ndihmes ekonomike dhe PAK Paskuqan (1 përgjegjës, 7 specialistë, 1 sanitare),

-36 punonjës Policia Bashkiake, 1 Kryeinsektor i policisë bashkiake, 7 inspektor, 1 krye asistent i policisë bashkiake, 27 asistent policisë bashkiake,

-526 punonjës Funksionet e deleguara.

Pagat dhe ndalesat tatimit mbi pagat personale e sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Bashkia Kamëz ka planifikuar dhe miratuar pagat për vitin 2023 për çdo vend pune sipas strukturave organizative, mbështetur në ligjin nr. 10405 datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” ndryshuar, në VKM nr. 165 datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, në VKM nr. 187 datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve pagave të nëpunësve civilë” ndryshuar, bazuar në klasat, kategoritë, pagën e grupit dhe shtesën për vjetërsi e pozicion. Pagat dhe shtesat mbi paga si vjetërsia e punës etj, janë përlogaritur drejtë, sipas tabelës pagave, në përputhje me VKM e sipërcituara. Për ndryshimet në vitin 2023 niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 29 datë 26.07.2023 në zbatim të VKM nr. 328 datë 31.05.2023, “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të qeverisjes vendore”. Detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurime shoqërore e shëndetësore janë llogaritur dhe ndaluar saktësisht për çdo muaj. Pagesat për punonjësit bëheshin për çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit që lëshohej nga drejtoria e burimeve njerëzore, e cila konfirmohej nga Kryetari i Bashkisë dhe i dërgohej drejtorisë së financës për veprime. Pagesat për shpërblimin e 41 anëtarëve të Këshillit Bashkisë janë kryer në masën 10 për qind të pagës së kryetarit të Bashkisë. Numri 41 i Këshilltarëve Bashkiak është bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 24 “Numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak” ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

b. Shpenzimet për ndihmën ekonomike.

Bashkia Kamëz për vitin 2023 ka 1607 familje, përfituese të ndihmës ekonomike.

Bashkia Kamëz për vitin 2023 ka 1280 persona përfitues të PAK.

Bashkia Kamëz për vitin 2023 paraqet 149 familje, përfituese nga 6%.

c. Shpenzimet operative.

Artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar në vlerën 125,617 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 101,533 mijë lekë ose në masën 81 %, nga këto të ardhura burim financimi:

Të ardhurat e veta në vlerën 26,856 mijë lekë,

Të ardhura nga granditë në vlerën 49,342 mijë lekë,

Nga transfertat e kushtëzuar në vlerën 2,054 mijë lekë,

Nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 23,281 mijë lekë,

Tabela nr.9: Shpenzimet operative sipas situacionit për vitin 2023, mënyrë analitike, paraqiten:

000/lekë

Shpenzimet Operative		Programet								
Nr	Emertimi	Shuma	1110	8130	8220	9120	9230	10430	5100	3280
1	Matëriale e shërbime zyre e të Përgjithshme	55,634	4,549		0	38,534	419	12,017		115
2	Matëriale dhe shërbime speciale	2,832	2,832	0	0	0	0	0		
3	Shërbime nga të tretët	188,908	10,766	1,018	2,374	12,581	4,889	2,503	154,652	124
4	Shpenzime transporti	8,934	4,234	0		0	0	0		4,699
5	Shpenzime udhëtimi	0	0	0		0	0	0		
6	Shpenzime mirmbajtje	2,486	2,486	0		0	0	0		
7	Shpenzime për qiramarrje	10,763	7,119	0		2,757	304	0		583
8	Shp.për detyrime dhe kompensime legale	14,770	14,770	0		0	0	0		
9	Shpenzime të tjera operative	21,192	16,045	0	4,745	0	402	0		
Shuma		305,520	62,802	1,018	7,119	53,872	6,015	14,520	154,652	5,521

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit

Peshë të rëndësishme në shpenzimet operative për vitin 2023 në Bashkinë Kamëz zënë shpenzimet për pastrimin.

Blerje Materiale zyre e të përgjithshme llogaria (6020) në vlerën 55,634 mijë lekë, përdorur për blerje ushqimesh në kopshte e çerdhe, materiale kancelarike, bojra printeri e të tjera.

Materiale dhe shërbime speciale (llog.6021) në vlerën 2,832 mijë lekë, përdorur për shpenzime interneti, banera, adegjiv e të tjera shpenzime dhe shërbime.

Shërbime nga të tretët llogaria (6022) në vlerën 188,908 mijë lekë, përdorur për shpenzime pastrimi në vlerën 154,652 mijë lekë, shpenzime për energji elektrike, shpenzime postare, banera, të tjera shpenzime dhe shërbime.

Shpenzime transporti llogaria (6023) në vlerën 8,934 mijë lekë përdorur për karburant, vaj filtra, siguracione automjetesh, mirëmbajtje të tjera, shpenzime transporti, ku pjesën më të madhe të shpenzimeve për karburant e zë sektori MZSH.

Shpenzime mirëmbajtje llogaria (6025) në vlerën 2,486 mijë lekë përdorur për mirëmbajtje e riparime të ndryshme.

Shërbime nga të tretët llogaria (6026) në vlerën 10,763 mijë lekë përdorur për marrje ambjentesh me qera për kopshte dhe zyra.

Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale llogaria (6027) në vlerën 14,770 mijë lekë përdorur për ekzekutim vendimesh gjykatë.

Shpenzime të tjera operative llogaria (6029) në vlerën 21,192 mijë lekë përdorur për likuidim, për shpërblimin e këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave dhe të lagjeve.

Shpenzimet operative për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike janë në vlerën 36,060 mijë lekë.

Shpenzimet operative për Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit e Treg janë në vlerën 15,077 mijë lekë.

Nga verifikimi rezultoi se akt-rakordimet ishin të rregullta në formë dhe në përmbajtje, pasi janë me sasinë e karburantit të furnizuar dhe të harxhuar si dhe gjendja në fund duke u firmosur nga personat përgjegjës.

-Akt-rakordimet janë plotësuar me gjithë të dhënat e kërkuara, ka çelje në fillim dhe në fund, ka datë dhe numër si dhe ka nënshkrime nga pala tjetër e drejtuesve të mjetëve dhe magazinieri.

-Gjithashtu akt-rakordimi pasqyron shumën e kilometrave mujore të përshkuara nga çdo makine sipas normativës së miratuar për efekt të justifikimit të karburantit të harxhuar.

Veprime në zbatim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36, ku thuhet:

Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes, objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentët duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa numërimit e dyfishtësh dhe atë të mashtrimeve.

Shpenzimet për automjetet.

Bashkia Kamëz ka hartuar normativat e harxhimit të karburantit për 100/km të përshkuara dhe për orë pune (për makineri të rënda) për automjetet e saj. Bashkia Kamëz për vitin 2023 disponon 9 automjete të cilat janë në gjendje pune.

Automjetet e Bashkisë Kamëz për vitin 2023 sipas llojit, markës, vlerës dhe normave të harxhimit të karburantit për 100 km, paraqiten në mënyrë analitike.

Tabela nr. 10 :Normativa e harxhimit të karburanteve të mjeteve

Nr	Marka	Modeli	Targa	Përgjegjësi	Harxhimi	Vlera (Lekë)	Aktive
1	Ford	Fugon	AA936LH	A. B	20 litra/100 km	1,177,529	Po
2	Ford	Fugon	AB178FN	B. K	9 litra/100 km	636,355	Po
3	Mercedez Benz	Autoveture	AB937AY	A. E	20 litra/100 km	1,250,954	Po
4	Hynday	Autoveture	AA883YL	L. K	16.5 litra/100 km	961,516	Po

5	Man	Zjarrfikese	AA593ZH	B. Gj	10 litra/ore ndezje ne vend, 20 litra/ore me pompe ndezur dhe 30 litra/100 km	1,257,668	Po
6	Daf	Zjarrfikese	AA932ZA,	B. Gj	10 litra/ore ndezje ne vend, 20 litra/ore me pompe ndezur dhe 30 litra/100 km	560,210	Po
7	Benz	Zjarrfikese	AA325FK	B. Gj	9 litra/ore ndezje ne vend, 18 litra/ore me pompe ndezur dhe 27 litra/100 km	271,947	Po
8	Hynday	Autoveture	AB875JP	M. H	12.7 litra/100 km	263,527	Po
9	Hynday	Autoveture	AB899JP	M. L	7.2 litra/100 km	290,235	Po
Shuma						6,669,941	

Burimi:Përpunuar nga grupi i Klsh-së

Nga verifikimi i dokumentacionit për karburantin e harxhuar nga automjetet për vitin 2023, u konstatua se janë mbajtur fletudhëtimet me nënshkrimet përkatëse, disponohen autorizimet e eprorit për furnizim me karburant, akt rakordimet për sasinë e naftës të furnizuar dhe të harxhuar dhe diferencat e mbetura, nuk u vërejtën mangësi ne dokumentacionin e tyre, konkretisht:

Fletudhëtimet paraqitën me rregullsi në plotësimin e tyre, plotësohen me km (kilometra) bazuar ne kilometrazhin e miratuar nga DPSHTRR për distancat midis rretheve dhe për distancat e rrugëve brendshme Bashkisë Kamëz.

-Janë hartuar normativat mujore për çdo makine, për vitin 2023.

Shpenzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve si dhe siguracionet paraqesin vlerën 8,934 mijë lekë, ose ne masën 2.9 % ndaj shpenzimeve operative konkretisht:

Blerje naftë dhe benzine për vlerën 6,670 mijë lekë.

Blerje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e riparime për vlerën 451 mijë lekë.

Likuidim siguracione makinash dhe siguracion jetë për zjarrëfikësit për vlerën 1,539 mijë lekë.

Të tjera shpenzime transporti për vlerën 274 mijë lekë.

Sipas analizës së mësipërme mjetet e Bashkisë Kamëz janë rentabël. Veprime ne përputhje me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për vlerësimin e programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor për vitin 2023 të Bashkisë Kamëz janë analizuar fillimisht planifikimet buxhetore afatmesme për përballimin e nevojave për vitet në vijim në bazë të eksperiencës së vitëve të kaluara dhe nevojave reale si pasojë e ndryshimeve në vitin e pritshëm buxhetor. Ky planifikim është detajuar sipas zërave të artikujve buxhetore në nivel klasifikimi 7-shifror sipas klasifikimit buxhetor të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim janë analizuar të gjitha shkresat e miratimit të buxhetit vjetor së bashku me ndryshimet gjatë vitit në funksion të përcaktimit të planit përfundimtar dhe në kuadër të ndryshimeve të autorizuar nga nivelet përkatëse autorizuese. Plani përfundimtar i buxhetit sipas shkresave përkatëse është krahasuar me situacionin progresiv të thesarit për të përcaktuar nivelin e planit përfundimtar dhe realizimin e tij. Për artikujt buxhetorë të cilët kanë pasur nivel më të lartë mos realizimi është bërë dhe një analizë më e detajuar në të cilën është identifikuar dhe përcaktuar devijimi në llogaritë përkatëse, qoftë nga ana cilësore apo nga ana sasiore. Auditimi është drejtuar edhe në përcaktimin e saktësisë së klasifikimit të zërave buxhetorë sipas realizimit dhe kryerja e testeve u orientua në krahasimin e situacionit faktik të realizimit të buxhetit të konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarin dhe databazës së publikuar të shpenzimeve të thesarit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nga të cilat nuk rezultuan devijime materiale. Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tirane si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik.

Akt-rakordimi i shpenzimeve vjetore ne total për vlerën 5,370,819 mijë lekë midis Drejtorisë së Financës dhe Thesarit Kamëz në fund të vitit 2023, është e analizuar sipas artikujve të shpenzimeve dhe burimit financimit tyre, sa vijon:

Tabela nr.11: Akt-rakordimi i shpenzimeve vjetore.

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2023 ne 000/lekë							
		Plani fillim sipas VKB	Çelja në thesarit sipas akt rakordim	Fakti sipas aktrakordimit	Të ardhura veta	Transferta pakushtëzuar	Trans. pakusht sektoriale	Trans. pakusht Rindërtim	Trans. kushtëz fonde të deleg
1	Paga 600	922,635	830,821	816,697	300,917	216,127	284,587	-	15,066
2	Sigurime 601	145,172	133,497	128,079	49,692	32,109	44,936	-	1,343
3	Shpenzime 602	536,813	386,906	361,882	242,054	71,782	42,821	-	5,226
4	Shpenzime 604	46,416	43,388	43,387	11,710	-	-	-	31,677
5	Transferta 606	886,376	828,189	812,916	45,565	2,690	382	68,837	695,442
6	F. Rezervë 609	30,400	-	-	-	-	-	-	-
	Shuma	2,567,811	2,222,802	2,162,962	649,938	322,708	372,726	68,837	748,753
7	Investime 230-231	3,643,893	3,561,076	3,207,857	1,120,127	416,079	748	1,260,572	410,331
	Shuma	3,643,893	3,561,076	3,207,857	1,120,127	416,079	748	1,260,572	410,331
	Totali	6,211,704	5,783,878	5,370,819	1,770,065	738,788	373,473	1,329,409	1,159,084

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances & Kontabilitetit

Akt rakordimi vjetor i shpenzimeve me thesarin përputhet me vlerën e shpenzimeve të realizuara prej 5,370,819 mijë lekë.

Buxheti përfundimtar për vitin 2023 i Bashkisë Kamëz me burim të ardhurat e veta, transferta pakushtëzuar, transferua e kushtëzuar specifike, funksione të deleguara dhe transferta e kushtëzuar për investime është realizuar 91 % ose për vlerën 5,370,819 mijë lekë nga 6,211,704 mijë lekë planifikimi, ose mos realizim në vlerën 840,885 mijë lekë, me hollësisht sipas artikujve:

Shpenzimet për paga (600) janë realizuar ne masën 88.5 % ose ne vlerën 816,697 mijë lekë nga 922,635 mijë lekë të planifikuara, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 300,917 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 216,127 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar sektoriale 284,587 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 15,066 mijë lekë.

Shpenzime për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Artikulli 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” janë realizuar ne masën 82.2 % ose në vlerën 128,079 mijë lekë nga 145,172 mijë lekë planifikimi, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 32,109 mijë lekë, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 49,692 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar specifike në vlerën 44,936 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 1,343 mijë lekë.

Shpenzimet operative (602) janë realizuar ne masën 67.4 %, ose ne vlerën 361,882 mijë lekë nga 536,813 mijë lekë të planifikuara, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 242,054 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 71,782 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 23,281 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 5,226 mijë lekë Mos realizimi i këtij artikulli 602 ka ardhur si pasojë e kursimeve gjatë procedurave të prokurimit si dhe një pjese e faturave të muajit dhjetor qe janë likujduar ne muajin janar të vitit 2024.

Shpenzime për investime (231+230) janë realizuar ne masën 88 %, ose në vlerë 3,207,857 mijë lekë nga planifikimi 3,643,893 mijë lekë, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 1,120,127 mijë lekë, nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 416,079 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar sektoriale në vlerën 748 mijë lekë, nga transferta e kushtëzuar për investime në vlerën 410,331 mijë lekë dhe nga transferta e pakushtëzuar Për rindërtimin në vlerën 1,260,572 mijë lekë. Vlera

me e lartë është për investimet e vitit ushtrimor ndërsa likuidimet e prapambetura të investimeve për llogari të viteve të mëparshme zënë vlerë të vogël.

“Transferime korrente të brendshme”, është realizuar në vlerën 43,387 mijë dhe planifikuar në vlerën 46,416 mijë lekë realizuar në masën 93.5 %.

“Transferime për buxhetë familjare dhe individë”, është planifikuar në vlerën 886,376 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 812,916 mijë lekë, e përbërë nga funksione deleguara në vlerën 695,442 mijë lekë dhe nga transfertat e pakushtëzuar për 2,690 mijë lekë, nga të ardhurat e veta në vlerën 45,565 mijë lekë, nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 382 mijë lekë dhe transfertat e pakushtëzuar për rindertimin në vlerën 68,837 mijë lekë .

-Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë:

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësitë të qeverisjes vendore, është krijuar fondi rezervë.

Në buxhetin e Bashkisë Kamëz për vitin 2023, është planifikuar fond rezervë në vlerën 30,400 mijë lekë vlerë e cila nuk është përdorur.

Fondi i Emergjencës për vitin 2023 është planifikuar për vlerën 71,578 mijë lekë, pasqyruar dhe në raportin e monitorimit 2023. Fondi Emergjencës është përdorur me miratim të Këshillit Bashkiak për vlerën 34,368 mijë lekë, sipas rastëve, konkretisht:

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 163 datë 21.12.2022 “Mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2023, 2024, 2025”, i ndryshuar është kryer planifikimi i fondit të emergjencave civile.

Subvencione: Bashkia Kamëz nuk ka pasur subvencione për vitin 2023.

Kredi të marra: Bashkia Kamëz nuk ka marrë kredi për vitin 2023.

Akt rakordimi vjetor i të ardhurave vendore për vitin 2023 me thesarin Kamëz, përputhet me vlerën e ardhurave të realizuara prej 1,808,971,806 lekë, sipas tabelës së të ardhurave e cila paraqitet në **aneksin nr. 2/6/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për 12 mujorin 2023 janë realizuar në vlerën 1,808,972 mijë lekë, e ndare sipas llojit të ardhurave:

Të ardhura tatimore në shumën 1,302,256 mijë lekë.

Të ardhura jo tatimore në shumën 505,452 mijë lekë, sipas të dhënave të mësipërme % më të lartë të realizimit e kanë të ardhurat jo tatimore në masën 85 %.

Sponsorizimet në shumën 1,264 mijë lekë.

2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZHR është konfirmuar se nuk ka detyrime të prapambetura ndër vite, por ai i krijuar në 2022 dhe 2023.

Tabela nr.12: Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2023, paraqitet ne pasqyrën e mëposhtme:

Detyrime	Detyrimi datë 31.12.2022	Krijuar detyrime gjatë vitit 2023	Shlyerja e detyrimeve 2023	Detyrimi datë 31.12.2023
Detyrime Për investime nga ministrinë e linjës/rindertimi dhe AKUM	245,284,000	421,489,791	430,750,591	236,023,200
Detyrime për investime nga Bashkia	155,501,000	77,986,111	145,414,212	88,072,899
Total detyrime për investime	400,785,000	499,475,902	576,164,803	324,096,099
Detyrime për mallra dhe shërbime	55,261,950	43,712,342	49,141,950	49,832,342
Detyrime për vendime gjyqësore		-	-	-
Detyrime total	456,046,950	543,188,244	625,306,753	373,928,441

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances & Kontabilitetit

Me mbylljen e vitit ushtrimor, rezultojne edhe vlerat e sakta të detyrimeve; gjithashtu kolona e gjendjes në fund të vitit 2022 është në vlerën e 456,047 mijë lekë (investime, mallra dhe shërbime). Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në menyre periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rrugë elektronike dhe shkresore. Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.

Raportimi në degën e thesarit për vitin 2023 është dorëzuar me shkresën nr.1316 prot., datë 14.02.2024, konform udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Deri në datën 31.12.2022 është në vlerën e 456,047 mijë lekë, ku 210,763 mijë lekë janë nga “investimet e Bashkisë” dhe “mallra dhe shërbime”; Për vendimet gjyqësore nuk ka detyrime; - Për vitin 2023 nga vlera e planifikuar dhe e miratuar me VKB për likuidim prej 210,763 mijë lekë, është paguar vlera 121,698 mijë lekë.

Detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2023 paraqitet në **aneksin nr. 2/1/4** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Detyrimet me burim financimi nga Fondet e Bashkisë:

1)Vendimet Gjyqësore.

Bashkia Kamëz aktualisht nuk ka procese gjyqësore për proçedura të vitit 2023 apo edhe për vitet paraardhëse për “dëmshpërblim page”, “shpronësime”, “dëmshpërblime” etj.

2) Detyrime për Investimet (nga të ardhurat e veta);

Në datën 31.12.2023 detyrime të prapambetura janë në shumën 155,500,629 lekë dhe përbëhet nga 19 projekte investimi. Gjatë vitit 2023 shtesa në vlerën 77,986,111 lekë për 7 projekte dhe pakësim të detyrimeve të prapambetura në vlerën 145,414,212 lekë për 15 projekte. Në datën 31.12.2023 kemi detyrime të prapambetura në shumën 88,072,528 lekë të cilat i përkasin 12 projekteve. Tabela e projekteve të palikuiduara analitike paraqitet në **aneksin nr. 2/1/5** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

3)Detyrime për mallra dhe shërbime (nga të ardhurat e veta)

Tabela nr.13: Detyrimet e prapambetura për mallra dhe shërbime:

Nr	Emërtimi i objektit	Emërtimi i subjektit	Detyrimi 31.12.2022	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Gjendja datë 31.12.2023
1.	Pagesa periodike sipas nenit 16 të kont. të koncens për pastrimin e qytetit	E C Shpk	49,141,950	43,712,342	49,141,950	43,712,342
2.	Blerje pelet për ngrohje	A Shpk	6,120,000			6,120,000
	Shuma		55,261,950	43,712,342	49,141,950	49,832,342

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances & Kontabilitetit

Nga auditimi rezultoi se Bashkia deri ne fund të vitit 2022 është debitore për mallra dhe shërbime ndaj 2 subjekteve me vlerë totale të faturës së shërbimit prej 55,261,950 lekë. Gjatë vitit 2023 janë pranuar për likuidim edhe 3 fatura në vlerën totale 43,712,342 lekë.

Detyrime të prapambetura të palikuiduara paraqiten në 14 raste për vlerën 137,904,870 lekë deri me datë 31.12.2023 nga Bashkia Kamëz.

Detyrimet e prapambetura prej 137,904,870 lekë sipas llojit detyrimeve në mënyre të grupuar, paraqitën sa vijon:

- Fatura të pa likuiduara për mallra paraqiten 1 rast për vlerën 6,120,000 lekë.
- Fatura të pa likuiduara për shërbime të ndryshme paraqitën 1 rast për vlerën 43,712,342 lekë.
- Fatura të pa likuiduara për investime paraqitën 12 raste për vlerën 88,072,528 lekë.

Vonesa në likuidimin e faturave.

Bashkia Kamëz paraqet vonesa në likuidimin e faturave të subjekteve për vitin 2023, pasi i përkasin vitit 2022 dhe 2023, pra nuk janë likuiduar brenda afatit ligjor, sipas pasqyrës së mëposhtme, në kundërshtim me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura në Njësitë Vetëqeverisjes Vendore” si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, ku citohet:

Neni 52: Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

Konkretisht:

- Me urdhër shpenzimin nr. 313 datë 09.03.2023, është likuiduar për objektin ndërtim rrjeti KUZ dhe furnizim me uje i zonës Valias i ri, për faturën nr. 12 datë 02.12.2022, pra ka kaluar afati 30 ditor.

-Me urdhër shpenzimin nr.314 datë 09.03.2023, është likuiduar për objektin ndërtim i rrjetit ujësjellës zona Fushë Kamëz, për faturën nr. 50, datë 11.05.2022, pra ka kaluar afati 30 ditor.

-Me urdhër shpenzimin nr.315 datë 09.03.2023, është likuiduar mbikqyrës ndërtim rrjeti ujësjellës dhe ndërtim KUN, Bashkim Gazidede-frutikulture, për faturën me nr. 301 datë 12.10.2021, pra ka kaluar afati 30 ditor.

Urdhër-shpenzimet e lartë-përmendura janë në vlerën totale 67,019,817 lekë.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë më përgjegjësi znj. V. S.

2.2.5: Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës/rindërtimi, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Njësitë vendore përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit. Ky fond përfitohet për financimin e projektëve për të cilat njësitë e qeverisjes vendore aplikojnë në fushat e infrastrukturës rrugore, arsimit, shëndetësisë etj. Fondi total i pa alokuar deri me datën 31.12.2023 për investimet është në vlerën 236,023,200 lekë.

Investimet e financuara nga buxheti i shtetit, të cilat nuk janë likuiduar deri me datën 31.12.2023 jepen në tabelën në vijim:

Tabela nr.13: Detyrime me burim financimi nga buxheti i shtetit.

Nr	Emërtimi	Subjekti	Detyrimi datë 31.12.2022	Krijuar detyrim. gjatë vitit 2023	Shlyerja e detyrimeve 2023	Detyrimi datë 31.12.2023
1	Nd. Rrjeti i ujësjellësit dhe KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku	Sh. A shpk	69,182,686		69,182,686	-
2	Nd. Rrjeti KUZ dhe furnizim me uji i zonës Valias i ri	I. Shpk	161,946,517	281,808,124	263,000,000	180,754,641
3	Rind. i Godinës Administrative në zonën e re për zhvillimin të detyruar në fshatin valias	S. 2 Shpk	2,131,579	33,298,326	35,429,905	-
4	Nd. Rrjeti ujësjellësit në zonën Fushe Kamëz	L. V Sha	6,313,522	105,084,654	60,000,000	51,398,176
5	Rikons Shkolles Mesme "I.Boletini"	S. 2 Shpk	2,638,000		2,638,000	-

6	Ndërtim KUZ dhe furnizim me ujë i zonës Valias i ri (mbikqyrje)	C.C Shpk	368,820	1,298,687	500,000	1,167,507
7	Rind. i shkolles 9-vjecare "Azem Hajdar ", NJA Babrru	E. Shpk	2,702,876			2,702,876
	Shuma		245,284,000	421,489,791	430,750,591	236,023,200

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances & Kontabilitetit

Nga auditimi rezulton se gjendja e detyrimit deri në datën 31.12.2022 e investimeve me burim financimi nga buxheti i shtetit ku përfshihen fondet e rindërtimit dhe fonde nga AKUM-i është në vlerën 245,284,000 lekë, nga kjo vlerë është likuiduar shuma 242,581,124 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 233,320,324 lekë. Total detyrimi në datën 31.12.2023 është në shumën 236,023,200 lekë.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Kamëz.

Vlera e raportuar nga Bashkia Kamëz në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është 137,904,870 lekë, konfirmuar me shkresën nr. 1348 prot., datë 15.02.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borsit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Tabela nr. 14: Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	7,003,158		1.31%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqësore			
4864200	Det.Prap. Shërbime	43,712,342		
4864201	D.P.Energji Elektrike			
4864300	Det.Prap. Mirëmbajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	88,072,528		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	6,120,000		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendetëore			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personale			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	137,904,870	3,330,843,288	4.14%

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz

Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 4.14 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Kamëz në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Referuar kontratave të investimeve aktive në Bashkinë Kamëz rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura është raportuar në përputhje me udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020 “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”

Raportimi i detyrimeve prapambetura në MFE, DPB dhe DFV për 2023, sipas raporteve të monitorimit.

Bashkia Kamëz ka raportuar detyrimet e prapambetura periodikisht në MFE, DPB dhe DFV për vitin 2023, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48, me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44, me UMFE 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit buxhetit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte Monitorimit Buxhetit Njësitë Qeverisjes Vendore”. Për vitin 2023 nga Bashkia Kamëz administrohen 3 raportet e monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit dhe detyrimeve të prapambetura si më poshtë:

Vlera është raportuar nga Bashkia Kamëz në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe Drejtorinë Financave Vendore me shkresën nr. 4197 datë 22.05.2023, për detyrimet e prapambetura Janar-Prill 2023.

Vlera është raportuar nga Bashkia Kamëz në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe Drejtorinë Financave Vendore me shkresën nr. 6910 datë 29.09.2023, për detyrimet e prapambetura Maj-Gusht 2023.

Vlera është raportuar nga Bashkia Kamëz në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe Drejtorinë Financave Vendore me shkresën nr. 1316 datë 14.02.2024, për detyrimet e prapambetura të vitit 2023 për vlerën 29,073,330 lekë, sipas llojit tyre, të cilat kanë kaluar afatin 60-ditor të likuidimit tyre.

2.2.6 Burimi i krijimit i të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qera të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Kamëz për miratimin e paketës fiskale të vitit 2023, me ndryshime;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga programi i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranim-faturimit dhe specialistët e kontrollit në terren dhe evidencat e korrespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifat vendore;

- Pasqyrat financiare për vitin 2023. Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2023;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore,

Në Bashkinë Kamëz bazuar në paketën fiskale strukturat për mbledhjen e të ardhurave janë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (në vijim DTTV); Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit (në vijim DPKZHT); Drejtoria e Kadastres, Bordit të kullimit pyjeve e kullotave; Drejtoria e transportit dhe licencave; Drejtoria e shërbimeve publike; UKK SHA.

Struktura Organizative është miratuar me VKB nr. 163, datë 21/12/2022, “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Kamëz për vitin 2023”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore,

DTTV është pjesë e strukturës organizative të miratuar dhe ka në varësi të saj 5 (pesë) sektorë që paraqiten si më poshtë:

- Për vitin 2023, kjo drejtori ka pasur këtë përbërje:
- -Drejtor (z. E. B);
- -Sektori i terrenit i përberë nga 21 (njëzet e një) punonjës, 20 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, znj. G. D;
- -Sektori i vlerësimit të detyrimit dhe menaxhimit të borxhit, i përberë nga 3 (tre) punonjës, 2 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, znj. L. K;
- -Sektori i taksave familjare i përberë nga 3 (tre) punonjës, 3 specialistë;
- -Sektori i mbrojtjes konsumatorit i përberë nga 7 (gjashtë) punonjës, 6 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, z. F.LI;
- -Sektori i analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve i përberë nga 4 (katër) punonjës, 3 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, znj. R.D.

Është krijuar struktura vendore e apelimit tatimor, ku me VKB nr. 42, datë 18.11.2019, është miratuar rregullore mbi organizimin e strukturës vendore të apelimit administrativ të taksave dhe tarifave vendore.

Vendimet e Këshillit Bashkiak janë publikuar në platformën online “Vendime.al”, dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.

Organizimi i veprimtarisë së DTTV bëhet duke u mbështetur në sistemin që menaxhon bazën e të dhënave në Bashkinë Kamëz.

Administrimi sistemit të taksave e tarifave vendore:

Sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave emërtohet TAIS (Microsoft Dynamics Nav3 2013 R2) (në vijim “Sistemi”). Ky sistem përpunon të dhënat e bazave të të dhënave.

Auditimi i “Sistemit” është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky sistem administron regjistrin elektronik për kategorinë biznes dhe familjar, në nivel lokal.

Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë ose kanë në përdorim një sistem manaxhimi të dhënash, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe

gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.

Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

Mbi përputhshmërinë e “Sistemit të manaxhimit të bazës së të dhënave për të ardhurat” në Bashkinë Kamëz me kuadrin ligjor në fuqi.

Auditimin i “Sistemit” është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të shërbimit që ofron. Ky sistem administron “Regjistrin Elektronik” për tatimpaguesit në kategorinë Biznes dhe Familjar, në nivel lokal.

Referuar të dhënave të mbledhura nga grupi i auditimit mangësitë e sistemit janë si mëposhtë:

1-Nuk ka një procedurë të përcaktuar për sigurinë e bazës së të dhënave shtetërore dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2-Mungon monitorimi i përdoruesve të sistemit si mëposhtë:

-Aksesimi i Log-eve të Sistemit dhe të Transaksioneve;

-Analiza e Kontrolleve të Sigurisë dhe të Aksesit;

-Shqyrtimi i Fjalëkalimeve dhe i IP-ve të Aksesit;

Vlerësimi i Protokolleve dhe i Rregullave të Menaxhimit të të dhënave;

Analiza e Veprimeve të Stornimit dhe Procesverbalet e Mbajtura;

Procedurat e ruajtjes dhe rikthimit të të dhënave në raste fatkeqësish (Back-up Plan);

Siguria dhe Kriptimi;

Politika e Ruajtjes së të Dhënave dhe Menaxhimi i të Dhënave të Përgjithshme;

Pra nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e sistemit të bazës së të dhënave që administron veprimtarinë e DTTV- së vlerëson së sistemi nuk siguron të dhëna të sakta dhe të sigurta.

Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Komponentëve klientë (“Përdoruesit e sistemit”) me kuadrin ligjor në fuqi.

Përdoruesit janë pjesë (softëare) e sistemit që përdor Bashkia Kamëz për manaxhimin e të ardhurave. Përdoruesit janë instaluar në kompjuterat personal në vijim “PC” që janë në përdorim të punonjësve të Drejtorisë. Informacioni që grumbullohet dhe përpunohet nga përdoruesit për kategoritë biznes dhe familjarë, ka të bëjë me regjistrimin, modifikimin, përlllogaritjen e detyrimeve për taksat e tarifat vendore, si dhe për arkëtimin e të ardhurave nga vjelja e tyre. Sistemi nëpërmjet raporteve që gjeneron i mundëson drejtimin, organizimin dhe monitorimin e punës për popullimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të sistemit.

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve si dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e

zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti. Për të garantuar kryerjen e kontroleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni, përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.

Me VKB nr. 137, datë 22.12.2021, është miratuar Paketa Fiskale për taksat dhe tarifave vendore nën juridiksionin e Bashkisë Kamëz.

Me VKB nr.96 datë 27.07.2022 janë miratuar ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore referuar VKB nr.137, datë 22.12.2021.

Me VKB nr.120 datë 29.09.2022 janë miratuar ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore referuar VKB nr.137, datë 22.12.2021.

Me VKB nr.157 datë 21.12.2022 janë miratuar ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore referuar VKB nr.137, datë 22.12.2021.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Tiranë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Kamëz për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike në **aneksin nr.2/6/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit. Për vitin 2023, Bashkia Kamëz ka parashikuar të ardhura nga taksat, tarifave vendore dhe taksat e ndara shumën 2,218,217 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 1,808,971 mijë lekë, ose 81.55 %, me një mosrealizim 409,245 mijë lekë. Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë debitorët e vitit për biznesin, taksë ndërtese, taksë trualli, taksa dhe tarifa lokale (familjarët).etj.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 24,684 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 40,203 mijë lekë ose realizuar në masën 162%. “Tarifë pastrim mbetjesh biznes” është planifikuar në vlerën 85,149 mijë lekë ndërsa arkëtimet në vlerën 101,848 mijë lekë ose realizuar në masën 119%. “Tarifa e kalimit të pronësisë ” është planifikuar në vlerën 3,376 mijë lekë ndërsa arkëtimet në vlerën 5,571 mijë lekë ose realizuar në masën 165 %. “Të ardhura nga lejet e ndërtimit dhe lejet e zhvillimit” janë planifikuar në vlerën 1,219,358 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,279,597 mijë lekë ose realizuar në masën 104%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

“Taksë ndërtese biznes” është planifikuar në vlerën 77,250 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 55,056 mijë lekë ose realizuar në masën 71%. “Taksë e gjelbërt biznes” është planifikuar në vlerën 18,401 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 677 mijë lekë ose realizuar në masën 3.68 %.

“Debitor biznes” është planifikuar në vlerën 63,654 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,508 mijë lekë ose realizuar në masën 11.8 %. “Tarifë ndriçimi biznes” është planifikuar në vlerën 10,296 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 304 mijë lekë ose realizuar në masën 2.96 %.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose mbivlerësim të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e

arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Kamëz që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Bashkia Kamëz ka disa agjentë tatimorë të cilat operojnë për mbledhjen e taksave të ndara për llogari të Bashkisë Kamëz.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Tatim-Taksave për vitin 2023:

Akt-Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë janë mbajtur për periudhën Janar-Dhjetor 2023, akt-rakordimet janë të firmosura nga personat përgjegjës nga Bashkia Kamëz dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

DRSHTRR Tiranë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Kamëz dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Tiranë.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2023 paraqiten në **aneksin nr. 2/6/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Detyrimet e familjarëve:

Me vendim të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 137, datë 23.12.2021 “Për Sistemin Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz”, me ndryshimet përkatëse, për vitin 2022 është miratuar taksë ndërtese për familjarët 2,000 lekë në vit për çdo familje, tarifë pastrimi gjelbërimi, ndriçimi 3,500 lekë, arsime 500 lekë, për çdo familje (vlera totale 6,000 lekë).

Regjistri i abonentëve familjarë dhe mënyra e tarifimit të tyre sipas paketës fiskale për vitin 2023 janë paraqitur në **aneksin nr. 2/6/3** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Në regjistrin e Taksapaguesve Familjarë të Agjentit Tatimor UKK SHA paraqitet informacioni si mëposhtë.

- 22,090 Familjet janë me gjendje civile në Kamëz dhe kanë një kontratë uji (tarifohen nga UKK);
- 1,840 familje kanë kontratë uji por nuk kanë gjendjen civile në Kamëz;
- 470 familje kanë më shumë se një kontratë;
- 418 familje mbajnë kontrata në emër të firmave ndërtuese;

Në regjistrin e Taksapaguesve Familjarë të DTTV-së:

-18,156 Familjet që janë me gjendje civile në Kamëz dhe nuk kanë kontratë (tarifohen nga DTTV) Ujësjiellës Kanalizime Kamëz ka në total 24,618 familje nga të cilat 23,930 faturohen për taksat familjare dhe 688 nuk faturohen se janë përfitues që përjashtohen totalisht nga taksat familjare (70-abonente janë emigrantë dhe nuk kanë banesë, 246 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 372 abonentë jetojnë në një banesë dhe në një çertifikatë).

Në **Pasqyrën nr.1:** Paraqitet realizimi sipas taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë:

Nr	Emërtimi	Plani	Fakti			realizimi %
			UKK	DTTV	Total	
1.	Ndërtesa	72,000,000	34,005,765	2,166,430	36,172,195	50%
2.	Pastrim	108,000,000	48,697,528	2,730,250	51,427,778	48%
3.	Truall	1,000,000	0	0	0	0%
4.	Taks e gjelbert	14,400,000	8,422,392	118,380	8,540,772	59%
5.	Tarifë ndriçimi	3,600,000	170,754	30,190	200,944	6%
6.	Arsimi	18,000,000	8,072,538	397,420	8,469,958	47%
7.	Debitor Familjarë	54,105,900	727,629	16,675,755	17,403,384	32%
	Total	271,105,900	100,096,605	22,118,425	122,215,030	45%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Kamëz

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2023, është në vlerën 271,106 mijë lekë dhe është realizuar 122,215 mijë lekë (sipas arkëtimeve në Bashki dhe akt rakordimeve me agjentin tatimor UKK), ose 45 % e planit vjetor.

Agjenti UKK SHA, vepron si agjent i Bashkisë Kamëz bazuar në aktmarrëveshjen nr. 409 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA.

Kjo marrëveshje, bazohet në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, VKB nr. 137, datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave e tarifave vendore në Bashkinë Kamëz”.

Lehtësira dhe përjashtime për taksapaguesit familjarë:

Në **Pasqyrën nr.2 :**Paraqiten lehtësirat dhe përjashtimet sipas paketës fiskale 2023:

Nr.	Kategori		Niveli i pagesës tarifave	Niveli pagesës (Leke/Vit)	DTTV	UKK	Total	Shënime
1	Invalidët e punës, te verbëritë, para-tetra plegjiket		30%	1800	252	153	405	
2	Kryefamiljaret gra		30%	1800	93	474	567	
3	Kryefamiljaret pensionist		30%	1200	864	1259	2123	Përjashtohen nga taksa e pasurisë
4	Te pa-aftet kryefamiljar		30%	1800	65	96	161	

5	Familjet qe jetojnë ne emigracion	Me Banesë	0 Leke	2000	362	215	577	
		Pa Banesë	0 Leke	0	70	1,458	1528	
6	Familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike		0 Leke	0	246	194	440	Përfshihen nga taksa e pasurisë
7	Familjet qe rrjedhin nga i njëjti trung familjar dhe jetojnë në një banesë		0 Leke	0	0	28	28	Përfshihen nga taksa e pasurisë

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Kamëz

Rakordimet e Bashkisë Kamëz me UKK SHA:

Rakordimet e Bashkisë Kamëz me UKK SHA për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për abonentë familjarë gjatë vitit 2023 janë kryer për periudha 3 mujore dhe jo çdo fund muaj. Rakordimi për muajt shkurt, mars, prill, maj 2023 është bërë me datë 12.06.2023, për muajt gusht, shtator 2023 është bërë me datë 20.10.2023. Rakordimet me agjentin tatimor UKK SHA paraqiten në **aneksi nr. 2/6/4** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Ky veprim nuk është në përputhje me aktmarrëveshjen nr. 674 prot., datë 24.01.2023, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, neni 10 pika 1, “Rakordimet”, ku cilësohet: *Bashkia Kamëz brenda datës 15 të çdo muaji pasardhës ngarkon DTTV të bëjnë rakordimet përkatëse me agjentin tatimor mbi të ardhurat e arkëtuara në përputhje me nenet 5 dhe 6 të kësaj marrëveshje, duke mbajtur akt rakordimin dypalësh sipas dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim.*

Sipas analizës së të ardhurave nga UKK SHA janë llogaritur arkëtimet që i takojnë vitit 2023 edhe pse pagesa për 2 muaj të vitit 2023 janë bërë në vitin 2024 në vlerën 18,143,091 lekë dhe 2 pagesa të vitit 2022 janë bërë në vitin 2023 me vlerë prej 15,473,722 lekë.

Në **Pasqyrën nr. 3** : Pagesat e vitit 2022 të kryera nga Agjenti Tatimor UKK SHA gjatë vitit 2023:

Nr.	Muaji	Totali Arkëtimeve (lekë)	Komisione 2.5% (lekë)	Paguar për Bashkinë (lekë)	Data Pagesës në bankë (financa)
1	Nëntor 22	7,653,937	191,348	7,462,588	09.03.2023
2	Dhjetor 22	8,216,549	205,413	8,011,134	27.03.2023
	Totali	15,870,486	396,761	15,473,722	

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Kamëz

Në **Pasqyrën nr. 4** : Pagesat e vitit 2023 të kryera nga Agjenti Tatimor UKK sha gjatë vitit 2024

Nr.	Muaji	Totali Arkëtimeve (lekë)	Komisione 2.5% (lekë)	Paguar për Bashkinë (lekë)	Data Pagesës në bankë (financa)
1	Tetor 23	9,264,743	231,618	9,033,124	09.01.2024
2	Dhjetor 23	9,343,556	233,588	9,109,967	06.02.2024
	Totali	18,608,299	465,206	18,143,091	

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Kamëz

Nga UKK sha, pagesa për muajin nëntor, dhjetor 2022, është kryer në mars 2023, për janar 2023 pagesa është kryer në prill 2023, ndërsa tetor -dhjetor është kryer në vitin 2024.

Ky veprim nuk është në përputhje me ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, Neni 7 pika 2, ku cilësohet, *Agjenti i mbajtjes së tatimit ka edhe këto detyra plotësuese, shkronja b) të paguajë tatimin në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj;* Neni 117, ku cilësohet, *Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme: a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike;* me aktmarrëveshjen nr. 674 prot. datë 24.01.2023, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, neni 10 pika 2, “Rakordimet”, ku cilësohet: *Pagesat për Bashkinë Kamëz*

bëhen brenda vitit fiskal, Agjenti Tatimor derdh në buxhetin e Bashkisë Kamëz të ardhurat e arkëtuara dhe rakorduara sipas vlerave në vijim.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1 prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. E. B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, znj. G. B, në cilësinë e përgjegjëses së terrenit, znj. L. K në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të vlerësimit të detyrimeve, z. E.S në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të taksave familjare dhe znj. R. D në cilësinë e përgjegjëses së analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

1.Pretendimi i subjektit:

Lidhur me Projekt Raportin e Auditimit, mbajtur nga audituesit e KLSH-së, vlerësojmë të japim disa sqarime;

Sa i përket pasqyrave të anekseve 6,7 dhe 8 ju konstatoni ndër të tjera se “Nga UKK SHA pagesa për muajn nëntor-dhjetor 2022, është kryer në mars 2023, për janar 2023 është kryer në prill 2023 ndërsa tetor-dhjetor është kryer në vitin 2024”. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në përputhje me ligjin 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ka bërë në mënyrë të vazhdueshme shkresë UKK SHA duke e njoftuar për kryerjen e pagesës me shkresat nr. 5392 prot, datë 19.07.2023 dhe nr.54/2 prot, datë 09.01.2024.

Gjithashtu ju bëjmë më dije se pagesa nuk është kryer në afat vetëm për muajit tetor 2023 për të cilin me marrjen e “Njoftimit dhe kërkesës për pagesë” nr 54/2 prot datë 09.01.2024 është shlyer detyrimi (*paguar më 09.01.2024*). Ndërsa për muajit dhjetor 2023 dhe janar 2024 për secilin pagesat kryhen respektivisht në vitin pasardhës pasi bëhen rakordimet (*për arkëtimet e muajit dhjetor 2023 rakordim datë 09.01.2024 (paguar më 06.02.2024) dhe për arkëtimet e muajit janar 2024 rakordim datë 20.02.2024 (paguar më 19.03.2024)* bazuar në nenin 10 pikën 1 të aktmarrëveshjes nr. 674 prot. datë 24.01.2023 si dhe pikës 2 të nenit 10 “Pagesat për Bashkinë Kamëz bëhen brenda vitit fiskal, Agjenti Tatimor derdh në buxhetin e Bashkisë Kamëz të ardhurat e arkëtuara dhe rakorduara sipas vlerave” si dhe në VKB-së nr. 137, datë 22.12.2021 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz” tek pika mënyra pagesës citohet shprehimisht “Afati pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit”.

1.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacioni e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për akt konstatimin nr.6, datë 18.10.2024. Marrëveshja e hartuar me UKK Kamëz e cila do të veproj si agjent tatimor për abonentët familjarë në Bashkinë Kamëz nuk është në përputhje me paketën fiskale nr.137, datë 22.12.2021 e cila citon “Ujësjiellës Kanalizime Kamëz do të derdhi cdo muaj shumat e arkëtuara për këtë taksë pranë cdo sporteli të Bankave të nivelit të dytë në numrin e llogarisë së Bashkisë Kamëz. Sipas akt marrëveshjes nr.674 prot, datë 24.01.2023 neni 10, pika 1 “Bashkia Kamëz brenda datës 15 të çdo muaj paraardhës, ngarkon DTTV që të kryej rakordimet përkatëse me agjentin tatimor mbi të ardhurat e arkëtuara në përputhje me nenet 5 dhe 6 të kësaj marrëveshje, duke mbajtur akt-akordim dy palësh sipas dokumentacionin të nevojshëm për këtë qëllim”, pika 2 “Pagesat për Bashkinë Kamëz bëhen brenda vitit fiskal, agjenti tatimor derdh në buxhetin e Bashkisë Kamëz të ardhurat e arkëtuara dhe rakorduara sipas vlerës”, Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

2.Pretendimi i subjektit:

Lidhur me akt konstatimin nr. 6, datë 18.10.2024, mbajtur nga audituesit e KLSH-së, vlerësojmë të japim disa sqarime;

Përsa i përket Pasqyrës së Aneksit 9 paraqitjes së situatës debitore të përmbledhur për kategorinë familjare, ju bëjmë me dije se:

a) DTTV ka marrë masat për arkëtimin e debisë për taksat dhe tarifat familjare për debitorët që administrojnë ajo në regjistrin e saj të taksapaguesve në sistemin e DTTV-së për vlerën e debisë të cituar sa më sipër.

-Me shkresën nr 8343 prot., datë 02.11.2023 DTTV i është drejtuar Ujësjetës Kanalizime Kamëz shpër ndarjen e njoftimit detyrimeve për taksapaguesit familjar me anë të faturistëve të saj. (Bashkëlidhur shkresa dhe disa njoftime detyrime)

-Gjithashtu me anë të specialistëve të taksave familjare janë bërë telefonata për njoftimin e familjeve debitore që administrojnë DTTV pra që janë jashtë zonës së mbulimit të agjentit tatimor UKK SHA sepse bazuar në rregulloren e brendshme “Vendimit Nr. 226, Datë 27.03.2023”, si dhe planin e punës të DTTV pika 8.3 përgjegjës për vjeljen e debisë janë specialitetet e taksave familjare sipas zonave që ata mbulojnë.

b) Për debitorët që administrojnë Agjenti Tatimor UKK SHA, bazuar në pikën (d) të nenit 1 dhe pikën (c) të nenit 4 të aktmarrëveshjes nr. 674 prot. datë 24.01.2023, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, është Agjenti Tatimor përgjegjës për mbledhjen e debisë për taksapaguesit familjarë (informuar agjentin tatimor UKK sha me shkresën nr 552 prot., datë 22.01.2024)

2.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për akt konstatimin nr.6, datë 18.10.2024 sektori i taksave familjare duhet të marrë masat konform udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”, pika 2 e udhëzimit bllokimi i llogarive bankare dhe pika 3.1 llojet e masave të sigurimit të detyrimit tatimor dhe afatet. Referuar sa më sipër në observacion nga sektori i taksave familjare nuk janë marrë masat sipas udhëzimit.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

3.Pretendimi i subjektit:

Lidhur me akt konstatimin nr. 6, datë 18.10.2024, mbajtur nga audituesit e KLSH-së, vlerësojmë të japim disa sqarime;

Ju më ngarkoni me përgjegjësi për mos pagesat në afat të detyrimeve për taksat familjare ndërkohë që pagesat janë bërë në afat bazur në ligjin 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKB-së nr. 137, Datë 22.12.2021 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar dhe aktmarrëveshjes nr. 674 prot. datë 24.01.2024 për Agjentin Tatimor.

Gjithashtu ju më ngarkoni me përgjegjësi për mos arkëtim me një sektor prej 4 katër punonjësish (1 përgjegjës dhe 3 specialistë) të një detyrimi të krijuar ndër vite (2011-2023) dhe për një numër të lartë debitorësh (41,254 familje, ndër to 13,687 pasivë - familjet që ndër vite janë larguar me leje banimi nga Bashkia Kamëz, bashkime familjare, vdekje si dhe familje që para vitit 2020 kanë patur debi dhe në vitin 2020 kanë kaluar nën administrimin e agjentit tatimor ukk sha për taksat/tarifat familjare).

Ndërkohë që Sektori i Taksave Familjare për aq sa e ngarkon planin e punës së DTTV-së, Rregullorja e Brendshme - Nr. 226, datë 27.03.2023, VKB-së nr. 137, datë 22.12.2021 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar, i mbështetur në ligjin 9920 datë 19.05.2008 dhe ligjin 9632 datë 30.10.2006, ka marrë masat për njohjen e këtyre subjekteve me detyrimet që ata kanë dhe ju ka kërkuar që të shlyejnë këto detyrime brenda afateve ligjore.

3.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacioni e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për akt konstatimin nr.6, datë 18.10.2024 referojmë si mëposhtë.

Bashkia Kamëz ka lidhur marrëveshje me agjentin tatimor UKK SHA me nr.674 prot, datë 24.01.2023 me qëllim mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë në territorin e Bashkisë Kamëz të cilit kanë të lidhur një kontratë uji me UKK SHA

Në Bashkinë Kamëz abonentë familjarë të cilët nuk kanë një kontratë me UKK SHA janë 18,156 familje të cilët tarifohen nga sektori i taksave familjare. Referuar vitit 2023 për këta abonentë debia është rritur për vlerën 91,593,460 lekë ose 90% e abonentëve janë debitorë e cila tregon një raport shumë të ulët të arkëtimit të abonentëve familjarë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion gjenden vetëm disa njoftim detyrimi për abonentët familjarë por për këta debitorë nuk është ndjekur procedura referuar udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”. Nuk është zbatuar pika 2 e udhëzimit bllokimi i llogarive bankare dhe pika 3.1 llojet e masave të sigurimit të detyrimit tatimor dhe afatet. Për sa i përket përgjegjësisë për nivelin e lartë të debitorëve duke marrë në konsideratë vetëm debinë e krijuar gjatë vitit 2023 dhe mos ndjekjen e masave shtrënguese për këta debitorë deyrat e sektorit të taksave familjare janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit dhe përgjegjësia do të mbahet për deyrat e mosrealizuara konform rregullores së brendshme.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Menaxhimi i borxhit për abonentët familjarë:

Abonentët familjarë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Kamzës paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 796,779,587 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga taksat dhe tarifat vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 17,425,898 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 779,353,689 lekë gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 150,504,806 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 929,858,495 lekë nga taksat dhe tarifat për abonentët familjarë. Vlera e kontabilizuar për detyrimet e abonentëve familjarë është 188,692,749 lekë. Diferenca e pakontabilizuar për detyrimet e abonentëve familjarë është 741,165,746 lekë. Gjatë vitit 2023 janë kontabilizuar debitorë të rinj në vlerën 14,651,568 lekë referuar informacionit të gjeneruar nga sistemi i cili menaxhohet nga Drejtoria e Taksave Vendore debitorët vetëm për vitin 2023 janë në vlerën 91,593,460 lekë ndërsa debitorët nga UKK SHA janë në vlerën 58,911,346 lekë. Sipas informacionit të mësipërm vetëm për vitin 2023 nuk janë kontabilizuar debitorë në vlerën 133,078,908 lekë.

Në **aneksin nr.2/6/5** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve progresive sipas njësive administrative për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2023.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. E.B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, znj. G. B, në cilësinë e përgjegjëses së terrenit, znj. L. K në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të vlerësimit të detyrimeve, z. E.S në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të taksave familjare dhe znj. Rudina Darsi në cilësinë e përgjegjëses së analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

1.Pretendimi i subjektit:

Sektori i taksave familjare, ka aplikuar çdo lloji mekanizmi për arkëtimin e detyrimeve ndër vite për taksat dhe tarifat familjare. Ky detyrim është detyrim progresiv i rritur ndër vite. Është kërkuar

periodikisht bashkëpunimi me Ujësjetellës Kanalizime Kamëz SHA për shpërndarjen e njoftim detyrimeve për vitin 2023 nga faturistët e zonave që mbulojnë. Gjithashtu nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë ngritur grupet e punës për kontraktimin e debitorëve dhe marrjen e masave përkatëse për arkëtimin e detyrimeve për taksat familjare sipas zonave.

Në vitin 2017 është miratuar ligji nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore” për faljen e detyrimeve të prapambetura deri në vitin 2010 por në Bashkinë Kamëz kjo amnistri nuk është aplikuar dhe rezulton vlera e debisë për taksat familjare shumë e lartë.

Për periudhën 2011-2018 vlera e debisë për taksat familjare është në shumën 334,183,100 lekë referuar nenit 100 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar citohet se: E drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej të kryhej”, ndodhur në këto kushte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e ka të pamundur vjeljen e këtyre detyrimeve. Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Drejtoria e Financës në zbatim të ligjit për buxhetin planifikojnë në buxhet vetëm debitorët e 2 viteve të fundit, debia e 2 viteve të fundit është në vlerën 188,692,749 lekë. Kërkojmë që debitorët e e sipërpërmendur të klasifikohen si debitorë pa shpresë arkëtimi.

1.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar programit të auditimit nr.1085/1 prot, datë 12.09.2024 i ndryshuar sipas pikës 2.6 të programit për auditimin e të ardhurave duhet evidentuar detyrimet tatimore progresive në Bashkinë Kamëz duke i ndarë në abonentë privatë dhe abonentë familjarë.

Referuar të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 debia për abonentët privatë është në vlerën 929,858,495 lekë. Shuma sipas sistemit duhet të jetë e kontabilizuar dhe të njihet si detyrim për këta abonentë debitorë. Referuar bazës së mësipërme ligjore, Bashkia Kamëz konform legjislacionit në fuqi mund të ndërmarrë veprime për sistemin e debitorëve duke marrë miratim nga Këshilli Bashkiak. Sipas akt konstatimit nr. 6 datë 18.10.2024 është përcaktuar debia totale e cila duhet të jetë e kontabilizuar dhe duhen ndërmarrë veprimet ligjore për vjeljen e detyrimit referuar udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, pika 2 e udhëzimit bllokimi i llogarive bankare dhe pika 3.1 llojet e masave të sigurimit të detyrimit tatimor dhe afatet. Koncepti i ndarjes së debitorëve me pak se 1 vit, nga 1-3 vjet dhe mbi 5 vjet përdoret për të ndarë moshën e borxhit dhe për të analizuar sa fonde mund të mbledhen nga këta debitorë.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë sipas llojit dhe kategorizimit:

Në **Pasqyrën nr.5** : Paraqitet numri i subjekteve sipas llojit për vitin 2023:

Nr.	Emërtimi	Numër Subjektesh
1	Biznes i Vogël	2,698
2	Biznes i Madh	786
3	Biznes Vip	56
4	Transport	278
Totali		3,818

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Kamëz

Sipas tabelës së mësipërme biznese aktive për vitin 2023 të ndara sipas madhësisë janë: Biznes i Madh (BM) 786 subjekte, Biznes i Madh Vip (BMV) 56 subjekte, Biznes i Vogel (BV) 2,698 subjekte, Transport 278 subjekte. Në total për vitin 2023 kanë ushtruar aktivitet 3,818 subjekte. Për vitin 2023 sipas llojit të biznesit të paraqitur në tabelën më sipër kanë ushtruar aktivitet 3,818 subjekte.

Në **Pasqyrën nr. 6:** Subjekte të mbyllura, çregjistruara, pezulluara

Nr.	Kategoria	Biznes i Vogël	Biznes i Madh	Transporti	Totali
1	Të çregjistruara	141	9	41	191
2	Të pezulluara	149	12	6	167
Totali		290	21	47	358

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Kamëz

Për vitin 2023, sipas llojit janë çregjistruar dhe pezulluar aktivitetin në QKB 358 subjekte.

Për vitin 2023, sipas llojit janë çregjistruar aktivitetin në QKB Biznes i Madh (BM) 21 subjekte, Biznes i vogel (BV) 290 subjekte, Transport 47 subjekte.

Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore për abonentët privatë.

Referuar kërkesës për informacion nga Grupi i Auditimit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka vendosur në dispozicion informacionin e mëposhtëm referuar situatës debitorë për abonentët privatë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore gjithashtu ka depozituar në Drejtorinë e Financës listën prej 595 subjekte debitorë me vlerë detyrimi 126,985,233 lekë për tu kontabilizuar.

Në **Pasqyrën nr.7:**Paraqitet informacion për subjektet debitorë biznes:

Nr	Njësitë	Lloji i bizneseve	Nr subjekteve	Detyrime datë 31.12.2022	Detyrime datë 31.12.2023
1	Kamzë	Biz.i vogël	595	21,002,863	8,569,411
		Biz.i madh		64,863,507	118,415,822
			595	85,866,370	126,985,233

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën 155,997,893 lekë.

Në **Pasqyrën nr.8:** Referuar vlerës debitorë të mësipërme vlera e detyrimit është analizuar sipas statusit të subjekteve në QKB.

Lloji i subjekteve	Nr	Vlerë
Aktiv	363	136,049,247
Pezulluar	130	7,979,740
Mbyllur	119	767,500

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar analizave të mësipërme vlera e detyrimit e raportuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në krahasim me gjendjen në sistem ka diferencë në shumën 29,012 mijë lekë. Diferenca midis vlerës së raportuar dhe vlerës në sistemin e Tatim-Taksave vjen për shkak sepse sistemi ka pasaktësi në nxjerrjen e raporteve. Janë analizuar subjektet dhe shumatat me diferencë midis raportit të sistemit dhe raportimit të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

Analiza për subjektet të cilat kanë diferencë midis vlerës në sistem dhe vlerës së raportuar paraqiten në **aneksi nr. 2/6/5** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Sa me sipër dalim në konkluzionin se nga strukturat tatimore të Bashkisë Kamëz, për subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe janë bllokuar llogaritë bankare nuk janë vazhduar procedurat referuar ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe

udhëzim i përbashkët Nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

III. Procedura për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore vendore.

Referuar udhëzimit të mësipërm Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me pikë 1.2 të udhëzimit të përbashkët dhe pika 3.1

1.2 Konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit Administrata tatimore vendore, mbështetur në nenin 89, pika 2, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të taksapaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi i taksave dhe tarifave vendore për të cilat kanë filluar masat shtrënguese. Taksapaguesi njoftohet paraprakisht se do të fillojë verifikimi dhe monitorimi në terren i aktivitetit tregtar të tij. Urdhri për të konfiskuar në fund të çdo dite një shumë jo më pak se 50% e qarkullimit ditor të realizuar por jo më shumë se detyrimi tatimor, lëshohet nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete. Në këtë urdhër, detyrimisht, përveç bazës ligjore duhet të theksohet edhe fakti që procedura që po ndiqet është në marrëveshje të plotë me administratën tatimore qendrore/rajonale, shprehur edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit e mirëkuptimit reciprok.

1.3.1 Llojet e masave të sigurimit të detyrimit tatimor dhe afatet kur me gjithë masat për bllokimin e llogarive bankare të taksapaguesit debitor, akoma detyrimet tatimore janë të papaguara, atëherë administrata tatimore vendore, brenda 10 (dhjetë) ditëve, zbaton masat e sigurimit të detyrimit tatimor. Përmbajtja e tyre është në formatin e shkresës zyrtare, si më poshtë: a) Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit tatimor; b) Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore; c) Njoftim për vendosjen e barrës siguruese. Njoftimi për taksapaguesin mbi vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor bëhet me qëllim që taksapaguesi: - të marrë dijeni për vendosjen e masës së sigurimit mbi pasuritë e tij; si dhe - të ketë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankimimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. E.B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, znj. G.B, në cilësinë e përgjegjëses së terrenit, znj. L.K në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të vlerësimit të detyrimeve, z. E.S në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të taksave familjare dhe znj. R.D në cilësinë e përgjegjëses së analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

1.Pretendimi i subjektit:

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore , Bashkia Kamëz në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKB nr.137, datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar si dhe udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore” ka ezauruar çdo hallkë procedurale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara për subjektet debitorë.

Pëe sa i përket procedurës së kallëzimit penal për mospagimin e taksave dhe tatimeve referuar pikës 1.3 të udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit

minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore” parashikohet se:

“Kur struktura përkatëse e taksave dhe tarifave vendore konsideron se pagesa e taksave dhe tarifave vendore është në rrezik dhe ndodhet përpara rasteve kur, 1-Taksapaguesi është vështirë të gjendet ose kërkon të largohet nga vendi, 2-Taksapaguesi kërkon që nëpërmjet likuidimit, falimentimit të shmangë pagesën e detyrimeve, 3-Taksapaguesi kërkon të kryejë transferim të shumave të parasë nga llogaria e tij me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve, 4-Taksapaguesi kërkon të shesë/transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë për të shmangur pagesën e detyrimeve.

Për sa më sipër nga debitorët e referuar nga grupi auditues, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është gjendur në asnjë nga rastet e cituara në pikën 1.3 të udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar observacioni të mësipërm Bashkia Kamëz në dokumentacionin e dërguar nga subjekti gjenden njoftimi dhe kërkesa për të paguar dhe urdhrat për bllokimin e llogarive bankare dërguar bankave të nivelit të dytë. Me shkresën nr.6792 prot, datë 18.09.2023 ju është dërguar bankave të nivelit të dytë urdhër për bllokimin e llogarive për subjektet pasive.

Me shkresën nr.7141 prot, datë 27.09.2023 ju është dërguar bankave të nivelit të dytë urdhër për bllokimin e llogarive për subjektet aktive. Me shkresën nr.7610 prot, datë 10.10.2023 ju është dërguar bankave të nivelit të dytë urdhër për bllokimin e llogarive. Në informacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për subjektet debitoare nuk është vendosur barrë hipotekore, barrë siguruese dhe njoftim për bllokimin QKB sipas udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore” pika 3.1.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Plotësimi i dosjeve të tatimpaguesve me dokumentacion.

Nga auditimi rezultoi se janë hapur dosje individuale për subjektet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh që ushtrojnë aktivitet në territorin geografik të Bashkisë Kamëz.

Nga grupi auditimit janë kryer disa testime për të verifikuar procesin e plotësimit të dosjeve me dokumentacion.

U përzgjedhën në mënyrë rastësore 44 subjekte për verifikimin e dokumentacionit në dosje dhe planifikimit/arkëtimit për taksa e tarifa vendore. Lista e subjekteve të përzgjedhura për auditim janë paraqitur në **aneksin nr. 2/6/3** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi, dosjet nuk janë të pajisura me fletën e inventarit. Në dosje nuk paraqitet dokumentacioni kronologjik për subjektin duke filluar nga momenti i hapjes, dokumentacionin e që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, tabelës për qëllim reklamimi etj. Në dosje nuk janë të dokumentuara akt verifikime vjetore të inspektorëve. Gjithashtu nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem (për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore), pra ndryshimet në sistem janë berë pa dokumentacion vërtetues pa procesverbalet e ndryshimit në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note).

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. E.B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe

Tarifave Vendore, znj. G.B, në cilësinë e përgjegjëses së terrenit, znj. L.K në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të vlerësimit të detyrimeve, z. E.S në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të taksave familjare dhe znj. R.D në cilësinë e përgjegjëses së analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

1.Pretendimi i subjektit:

Sektori i verifikimit në terren pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në zbatim të liogjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar pas verifikimeve që kryhen në terren si dhe dokumentacionin që depozitohet nga subjektet tatimpaguese, mbahen aktkontrollat dhe procesverbalet për përlllogaritjen e detyrimeve vendore sipas parashikimeve ligjore të paketës fiskale në fuqi. Për çdo dosje të subjekteve tatimpaguese administrohet dokumentacioni si mëposhtë:

- Inventari i dosjes (ku evidentohet dokumentacioni justifikues);
- Certifikata e regjistrimit të subjektit tatimpagues;
- Ekstrakti historik;
- Përgjegjësia tatimore e subjektit;
- Dokumentacioni justifikues për tabelat që kanë funksion reklamues;
- Mjet identifikimi;

Korrespondenca me subjektet tatimpaguese sipas rastit;

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka paraqitur dokumentacionin justifikues për subjektet e mëposhtme:

1-G. GJ. Nipti- M.....3

2- S. A. Nipti-M.....2

3-K. N. Nipti M.....2

4-I. Shpk Nipti K.....11

5-O. O. Shpk NIPTI K.....31

6-H. A. Shpk Nipti I.....01

7-A. Sh. Shpk Nipti L.....21

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore sqarojmë si mëposhtë:

Referuar observacionin të mësipërm nga 44 dosjet e përzgjedhura për auditim është dërguar dokumentacion vetëm për 7 subjekte për të cilat përsëri informacioni i dosjes nuk është i plotë. Dosja fizike e subjektit duhet të përmbajë informacionin kronologjik për subjektin dhe dokumentacionin sipas përgjegjësisë tatimore sipas paketës fiskale.

Referuar informacionit të mësipërm nuk kemi informacion për disa subjekte për taksën e ndërtesës, taksën e truallit, për subjektet të cilat operojnë në fushën e ndërtimit lejet e ndërtimit duhet të bashkëngjiten në dosje për tu patur në konsideratë afati i lejes e cila do të jetë dhe periudha që ky subjekt do të duhet të tarifohet sipas paketës fiskale. Edhe gjatë fazës në terren nga inspektorët e terrenit kur është nxjerrë problematika e dokumentacionit në dosje është pranuar si fakt mos dokumentimi i proceseve të punës me veprimet në sistem.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

➤ Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Kamëz-Vorë, u auditua dokumentacioni për vitin 2023,

i paraqitur nga Drejtoria TTV. Nga DVASHK, janë dërguar listat për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Për vitin 2023, janë pajisur me leje legalizimi 671 objekte informale me vlerë detyrimi 25,123,258 lekë (bazuar në listat që bashkia administron).

Detyrimi progresiv për taksën e infrastrukturës nga legalizimet në datën 31.12.2022 është në vlerën 297,508,793 lekë dhe përbehet nga 8,608 debitorë. Gjatë vitit 2023 për taksën e ndikimit në infrastrukturë janë faturuar 671 persona me vlerë detyrimi 25,123,258 lekë. Për taksën e ndikimit gjatë vitit 2023 kanë paguar detyrimin 192 persona në vlerën 10,398,475 lekë. Detyrimi progresiv në datë 31.12.2023 është në vlerën 312,233,577 lekë ky detyrim i përket 9,087 debitorëve.

Në Pasqyrën nr.9 :Paraqiten të dhëna për taksën e infrastrukturës për vitin 2023:

Viti	Numri i objekteve të legalizuara që janë debitorë më 31.12.2023	Vlera e detyrimit total	Pagesat në numër	Vlera e paguar	Debitorë në numër	Shuma debitorë
2014	234	10,620,652	156	6,984,211	78	3,636,441
2015	1055	44,315,979	865	35,328,837	190	8,987,142
2016	578	23,901,354	249	9,439,091	329	14,462,263
2017	3643	161,385,596	1609	96,903,208	2,034	64,482,388
2018	2881	121,493,030	909	52,367,660	1,972	69,125,370
2019	2899	118,468,644	1,499	77,352,077	1,400	41,116,567
2020	1134	39,042,041	497	17,897,338	637	21,144,703
2021	1085	39,998,000	127	5,087,205	958	34,910,795
2022	1254	49,323,612	244	9,680,488	1,010	39,643,124
2023	671	25,123,258	192	10,398,474	479	14,724,784
	15,434	635,133,241	6,347	321,438,589	9,087	312,233,577

Burimi:Bashkia Kamëz

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Kamëz për periudhën ushtrimore ka njoftuar subjektet debitorë por nuk u evidentuan raste që Bashkia Kamëz të jetë drejtuar ASHK, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27. Udhëzimi i përbashkët Nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetin minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore” pika 3.1.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. E.B, znj.G.B, znj. L.K, z. E.S dhe znj. R.D ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar observacioni të mësipërm Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bashkëngjitur njoftim detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë gjithashtu ka kërkuar nga Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA mundësi bashkëpunimi të cilën e ka finalizuar në vitin 2024. Me VKB nr. 86, datë 22.08.2024 “Për caktimin e UKK si agjent tatimor për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë” gjithashtu është lidhur dhe marrëveshja e bashkëpunimit me nr.7602 prot, datë 16.09.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacioni e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore sqarojmë si mëposhtë.

Referuar observacionit të mësipërm Drejtoria e Taksave Vendore, Bashkia Kamëz për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë ka dërguar vetëm njoftim detyrimit nuk ka ndjekur procedurën referuar udhëzimit të përbashkët Nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetin minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

III. Procedura për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore vendore, pika 3.1

1.3.1 Llojet e masave të sigurimit të detyrimit tatimor dhe afatet kur me gjithë masat për bllokimin e llogarive bankare të taksapaguesit debitor, akoma detyrimet tatimore janë të papaguara, atëherë administrata tatimore vendore, brenda 10 (dhjetë) ditëve, zbaton masat e sigurimit të detyrimit tatimor. Përmbajtja e tyre është në formatin e shkresës zyrtare, si më poshtë: a) Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit tatimor; b) Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore; c) Njoftim për vendosjen e barrës siguruese. Njoftimi për taksapaguesin mbi vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor bëhet me qëllim që taksapaguesi: - të marrë dijeni për vendosjen e masës së sigurimit mbi pasuritë e tij; si dhe - të ketë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankimit.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Kamëz dhe UKK kjo është lidhur në vitin 2024 periudhë e cila nuk është objekt auditimi referuar programit të auditimit nr .1085/1, datë 12.09.2024.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjobat e IMTV

Gjatë vitit 2023 nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Kamëz për periudhën objekt auditimi janë vendosur 70 (shtatëdhjetë) gjoba në vlerën **24,161,308 lekë** nga të cilat deri në datën 31.12.2023 është arkëtuar vlera **3,635,287 lekë**, për 26 (njëzet e katër) gjoba të vendosura. Nga këto 24 gjoba me vlerë 3,248,187 lekë janë likuduar ndërsa për 2 gjoba me vlerë detyrimi 1,011,350 janë lidhur akt marrveshje dhe për vitin 2023 është likuajduar vlera 387,100 lekë. Për 46 gjoba të vendosura nga IMTV në vlerën **20,913,121 lekë** deri në fund të vitit 2023 kanë qënë të palikujduara. Referuar informacionit për vitin 2024, për 15 gjoba me vlerë detyrimi 3,378,475 lekë janë lidhur akt marrëveshje ose janë paguar gjobat. Për 29 gjoba me vlerë detyrimi 16,273,296 lekë janë të palikujduara dhe për këto gjoba nuk është dorëzuar praktika ligjore për nxjerrjen e urdhrat të ekzekutimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Veprime në kundërshtim me ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve”

Gjoba dhe shumat, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur: a) është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv; b) vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë.

Referuar ligjit nr.127, datë 19.12.2024, “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01.01.2015-30.11.2024 nga Inspektoriatët Vendorë të Mbrojtjes së Territorit, Inspektoriat i Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriat i Shtetëror Shëndetësor si dhe Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake”, i cili citon neni 1 “Shfuqizohen të gjitha masat administrative të paekzekutuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, të vendosur nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024”, neni 2 “Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë bërë ndërtime dhe/ose ndërhyrje pa leje apo njoftim paraprak, në ndërtime për qëllime banimi, në objekte ku kryhen veprimtari të prodhimit, magazinimit,

përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbajtjes të mjeteve të punës e inputeve bujqësore dhe blegtorale, “Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë objekt të aktivitetit të tyre prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale”.

Tabela e gjobave të vendosura gjatë vitit 2023 nga IMTV dhe likujdimi i tyre ose gjendja debitoare janë pasqyruar në **aneksin nr. 2/6/7** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. J.D, në cilësinë e Kryeinspektorit të Drejtorisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes Vendore ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar projekt raportit për auditimin në Bashkinë Kamëz ardhur me anë të shkresës nr.1085/4 prot, datë 16.12.2024 paraqesim argumentat si mëposhtë:

Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Kamëz, për vitin 2023 ka nxjerrë 70 vendime për dënim me gjobë për subjektet fizikë/juridik. Gjatë vitit 2024 është likujduar total detyrimi për 44 vendime.

Janë 5 subjekte të cilat kanë lidhur akt-marrëveshje me Bashkinë Kamëz.

Referuar informacionit të mësipërm deri në fund të vitit 2024 kanë likujduar detyrimin 44 subjekte dhe 5 subjekte janë më proces likujdimi me këste.

Referuar informacionit 21 vendime nuk janë paguar ose janë në proces likujdimi, për këto vendime 10 prej tyre janë ankimuar në gjykatë, ku për 3 subjekte janë rrëzuar kërkesë paditë nga gjykata, për 1 subjekt është shfuqizuar nga gjykata, ndërsa 6 subjekte janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë.

Në zbatim të VKB nr.113, datë 19.11.2021 për vjeljen e gjobave të vendosura nga IMTV ka qenë e ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e cila ka në përbërje strukturën e ekzekutimit të detyrimeve.

Referuar ligjit nr.127, datë 19.12.2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01.01.2015-30.11.2024 nga Inspektoriatët Vendorë të Mbrojtjes së Territorit,Inspektoriat Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriat Shetëror Shëndetësor si dhe Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake”, nuk mund të vazhdojmë më me vjeljen e detyrimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar programit të auditimit financiar në Bashkinë Kamëz periudha e auditimit është 01.01.2023-31.12.2023.Informacioni i përcjell nga IMTV përfshin edhe periudhën e vitit 2024 e cila nuk është objekt i auditimit. Grupi i auditimit ka pasqyruar gjendjen e pagesës së gjobave deri në datën 31.12.2023 gjithashtu ka marrë në konsideratë edhe akt marrëveshjet e lidhura gjatë vitit 2024 dhe është shprehur vetëm për gjobat për të cilat nuk është ndjekur praktika ligjore për vjeljen e këtij detyrimi. Referuar ligjit nr.127, datë 19.12.2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01.01.2015-30.11.2024 nga Inspektoriatët Vendorë të Mbrojtjes së Territorit,Inspektoriat Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriat Shetëror Shëndetësor si dhe Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake”, 29 vendime për gjoba me vlerë detyrimi 16,273,296 lekë nuk mund më të arkëtohen nga strukturat për arkëtimin e debitorëve ose këto vendime të dërgohen në gjykatë.

Për sa më sipër, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Kamëz dhe në Njësitë Administrative, ushtrojnë aktivitetin 42 subjekte që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin në këtë fushë paraqiten të dhëna **në aneksin nr.2/6/8** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve të licensuara u konstatua se situata paraqitet si mëposhtë:

1. Subjekti “A. P, me NUIS K....82, ushtron aktivitet, tregti me shumicë dhe pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Demokracia, Paskuqan, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 06.12.2022-05.12.2023. Pasi ka mbaruar afati i autorizimit subjekti ka rinovuar autorizimin nga data 06.12.2022-05.12.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

2. Subjekti “D.O”, me NUIS K.....02, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Babrru qendër, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 29.12.2022-28.12.2023. Nga auditimi rezulton rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën për licencimin dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

3. Subjekti “D. O”, me NUIS K.....02, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Demokracia, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me autorizim nga data 29.12.2022-28.12.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën për autorizimin dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

4. Subjekti **“D”** shpk me NUIS K.....31, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Demokracia, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me autorizim nga data 30.11.2022-29.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

5. Subjekti **“L.P”** shpk me NUIS L...52, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Laknas, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me autorizim 1 vjeçar nga data 21.10.2022-20.10.2023 pasi ka mbaruar afati i autorizimit subjekti ka rinovuar autorizimin nga data 19.10.2023-18.10.2024. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

6. Subjekti **“P.K”** shpk me NUIS L.....52, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Bathore, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me autorizim nga data 28.03.2022-03.01.2023 pasi ka mbaruar afati i autorizimit subjekti ka rinovuar autorizimin nga data 27.03.2023-26.03.2024. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 202,000 lekë për licencimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

7. Subjekti **“S”** shpk me NUIS K.....04, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Valias, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me autorizim nga data 25.07.2022-24.07.2023 pasi ka mbaruar afati i autorizimit subjekti ka rinovuar autorizimin nga data 25.07.2023-24.07.2024. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për*

automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”

8. Subjekti “S” shpk me NUIS K.....04, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Laknas, Bashkia Kamëz.

Subjekti është pajisur me autorizim nga data 27.03.2023-26.03.2024. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

9. Subjekti “R” shpk me NUIS L.....61, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Babrru qendër, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 27.04.2023-26.04.2028. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 1,002,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 1,002,000 lekë në përputhje me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017.

10. Subjekti “Q” shpk me NUIS L.....02, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Bathore, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 13.09.2021-12.09.2026. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 1,002,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 1,002,000 lekë në përputhje me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017.

11. Subjekti “L.O” shpk me NUIS L.....58, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Bathore, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 08.11.2022-07.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

12. Subjekti “L.O” shpk me NUIS L.....58, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti bulevardi Nënë Tereza Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 08.11.2022-07.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat*

lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”

13. Subjekti **“LI.O”** shpk me NUIS L.....58, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Berisha, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 09.11.2022-08.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

14. Subjekti **“G.C”** shpk me NUIS K.....66, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Demokracia, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 15.11.2022-14.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

15. Subjekti **“G.C”** shpk me NUIS K.....66, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti bulevardi Nënë Tereza Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 11.11.2022-10.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”*

16. Subjekti **“G.C”** shpk me NUIS K.....66, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Berisha, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 11.11.2022-10.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon *“Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së*

karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”

17. Subjekti **“K”** shpk me NUIS J.....6, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Bulevardi Nënë Tereza ,nr pasurie 11/647,Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 21.01.2022-20.01.2027.Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 1,002,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 1,002,000 lekë në përputhje me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017.

18. Subjekti **“K”** shpk me NUIS J.....6, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Bulevardi Nënë Tereza, nr pasurie 7181, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 21.01.2022-20.01.2027.Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 1,002,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 1,002,000 lekë në përputhje me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017

19. Subjekti **“V.P”** shpk me NUIS K.....63, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Demokracia, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 08.11.2022-07.11.2023.Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë.Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*”

20. Subjekti **“K.K.”** shpk me NUIS K.....31, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti rruga Demokracia ,Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 09.12.2022-08.12.2023.Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*”

21. Subjekti **“B.P”** shpk me NUIS L.....71, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti bulevardi Nënë Tereza,Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 01.12.2022-30.11.2023.Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë.Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për*

stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”

22. Subjekti **“B.P”** shpk me NUIS L.....71, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti bulevardi Nënë Tereza , nr pasurie 1/138-ND,Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 01.12.2022-30.11.2023.Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka kryer pagesën 202,000 lekë për autorizimin. dhe është pasqyruar debitor për vlerën 202,000 lekë.Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*”

23. Subjekti **“Sh.A.”** shpk me NUIS K.....31, ushtron aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Bulevardi Nënë Tereza, nr pasurie 7181, Bashkia Kamëz. Subjekti është pajisur me autorizim nga data 17.02.2020-16.02.2025 .Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën 1,002,000 lekë për autorizimin. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit detyrimi i përlllogaritur është në shumën 1,002,000 lekë në përputhje me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017.

Gjatë vitit 2023 Drejtoria e Licencave dhe Transportit, Bashkia Kamëz ka autorizuar 18 subjekte të hidrokarbureve me afat 1 vjeçar, tarifa e ngarkuar subjekteve për këtë autorizim është në shumën 202,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 e cila citon “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*”

Gjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë së Kamzës kanë operuar 14 subjekte me aktivitet tregtimin me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve pa u pajisur me autorizim përkatës nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit. Në tabelën në vijim janë paraqitur subjektet pa autorizim.

Në **Pasqyrën nr. 10:** Subjekteve e hidrokarbureve që ushtronjë aktivitet pa autorizim.

Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Aktivitet	Debitor 2022	Detyrim i ngarkuar 2023	Detyrimi i paguar	Diferenca
1	D. O	L52	Valias	Karburant	-	202,000	-	202,000
2	E. O	L42	Bul Nënë Tereza	Karburant	202,000	202,000	-	404,000
3	P. G	L81	Rr. Donald Trump	Karburant	52,000	52,000		104,000
4	O.O	J63	Ish Guzja	Karburant	202,000	202,000	202,000	202,000
5	O. O	J63	Kamez ish R.Nika	Karburant	202,000	202,000	202,000	202,000
6	K	L51	N.Tereza Laknas	Karburant	404,000	202,000	-	606,000
7	K	J61	Paskuqan	Karburant	202,000	624,000	-	826,000
8	O. O	K31	Kamëz	Karburant	424,000	202,000	-	626,000
9	S. P	L32	Rr. Skënderbeu	Karburant	202,000	202,000	-	404,000
10	T. D	L62	Donald Trump	Karburant	104,000	52,000	-	156,000
11	A.P	L52	Babru qender	Karburant	-	paguar debinë për një vit		
12	A.G	L92	Rr. Skënderbeu	Tregti gazi	104,000	52,000	-	156,000
13	A.G	L92	Rruga Berisha	Tregti gazi	104,000	52,000	-	156,000

14	B.L	L52	Nënë Tereza	Tregti gazi	-	104,000	-	104,000
----	-----	-----	-------------	-------------	---	---------	---	---------

Burimi: Bashkia Kamëz

Drejtoria e Licencave dhe Transporti gjatë vitit 2023 ka lejuar veprimtarinë e 14 subjekteve pa autorizim përkatës në kundërshtim me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 15.1 e cila citon: *Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit këto subjekte janë ngarkuar me detyrim vjetor, duke mos patur autorizim për këto subjekte nuk lind detyrim tatimor por këto subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizim duhet vepruar sipas VKM së mësipërme. Vetëm subjektet të cilat pajisen me autorizim ju lind detyrim tatimor.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:

1)VKM nr. 170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.

2)VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 2; germa “a-g”.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1 prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. Sh.L , në cilësinë e ish-Drejtorit në Drejtorinë e Licencave dhe Transportit ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar projekt raportit për auditimin në Bashkinë Kamëz ardhur me anë të shkresës nr.1085/4 prot, datë 16.12.2024 paraqesim argumentat si mëposhtë:

Autorizimet për subjektet e hidrokarbureve me afat 1 vjeçar janë bazuar në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar neni 20 autorizimet ku citohet:

1. Licencat u jepen personave juridikë të parashikuar në pikat “ç” dhe “d”, të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikantë për automjetet dhe për shitjen e lëndëve djegëse.

2. Licencat për pesonat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritje. Licencat janë dhënë për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritje dhe janë tarifuar për periudhën kohore sa është autorizimi.

Referuar VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore është përcaktuar tarifa për 1 vit në shumën 200,000 lekë dhe tarifa për 5 vite në shumën 1,000,000 lekë.

Referuar subjekteve të cilat operojnë pa autorizim përkatës ju informojmë si mëposhtë:

1.Subjekti K me nipt K.....31 është pajisur me autorizim nr.050/12, datë 09.12.2022.

2.Subjekti A.M me nipt L.....52 ka pezulluar aktivitetin me datë 03.10.2023.

3.Subjekti A.G shpk me nipt M.....11 ka pezulluar aktivitetin me datë 17.03.2022.

4.Subjekti A.A me nipt L.....71 ka hequr adresën nga territorin e Bashkisë Kamëz me datë 04.03.2022.

5.Subjekti B me nipt L.....52 nuk operon në territorin e Bashkisë Kamëz.

6.Subjekti O. O me nipt J.....63 nuk operon që nga viti 2022 pjesa e detyrimit është vlere debitore e viteve të mëparshme.

7.E.O ka mbyllur aktivitetin në vitin 2023 dhe vlerën e detyrimit e ka paguar E. Shpk.

8.Subjekti L.P ka paguar detyrimet.

9.Subjekti G. shpk ka mbyllur aktivitetin dhe detyrimin e ka paguar subjekti D. shpk.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar programit të auditimit financiar në Bashkinë Kamëz periudha e auditimit është 01.01.2023-31.12.2023. Sipas VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave është përcaktuar së “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*”. Referuar bazës së mësipërm ligjore. Pagesa për licenca është në shumën 1,000,000 lekë dhe kryhet në momentin e licencimit të subjektit, periudha e licencimit të subjekteve është me afat deri në 5 vite sipas nenit 20 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Bazuar si mësipër edhe subjektet të cilat janë licencuar me afat 1 vjeçar janë të detyruar të kryejnë pagesë 1,000,000 lekë për shkak sepse afati i licencimit nuk është i lidhur me shumën e pagesës por çdo subjekt që autorizohet nga Bashkia për tregtimin e hidrokarbureve i lind detyrim në vlerën 1,000,000 lekë.

Referuar VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në të cilën është përcaktuar tarifa për 1 vit në shumën 200,000 lekë dhe tarifa për 5 vite në shumën 1,000,000 lekë është miratuar në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

Sipas observacionit të mësipërm do të konsiderohet në hartimin e materialit informacioni për subjektet si mëposhtë:

1- K me Nipt K

2- A.G shpk me Nipt M

3- A.A me nipt L7

4- G. shpk

5- B me nipt L52

Subjektet e mëposhtme nuk do të konsiderohen informacioni i sjell me observacion :

-Subjekti A.M me nipt L52 nuk është në listën e subjekteve të pasqyruara në tabelën nr.10.

-Subjekti O.O me nipt J63 referuar të dhënave të shkarkuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit në ekstraktin historik nuk paraqitet informacion për këtë subjekt të ketë hequr adresën e ushtrimit të aktivitetit në Bashkinë e Kamzës.

-Subjekti E.O. referuar të dhënave të shkarkuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit në ekstraktin historik nuk paraqitet informacion për këtë subjekt të ketë hequr adresën e ushtrimit të aktivitetit në Bashkinë e Kamzës.

Për sa më sipër, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1 prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. A.Gj, z. A.N, z. B.T, z. E.Sh, z. F.Sh, z. V.P në cilësinë

e specialistëve në Drejtorinë e Licencave dhe Transportit ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

1) Pretendimi i subjektit:

Referuar projekt raportit për auditimin në Bashkinë Kamëz ardhur me anë të shkresës nr.1085/4 prot, datë 16.12.2024 paraqesim argumentat si mëposhtë:

Gjatë vitit 2023 specialistët e terrenit nuk janë ngarkuar me asnjë urdhër pune ose urdhër të brendshëm me objekt “ Inspektimin dhe evidentimin e subjekteve që ushtronjë aktivitet tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, pa autorizim përkatës.

Referuar përshkrimit të punës dhe përgjegjësi për çdo pozicion punë të Drejtorisë së Transportit, Lejeve dhe Licencave nr.1491/1 prot, datë 23.02.2023, pika 4 “Zbatimin e procedurave ligjore për dhënien e licencave, lejeve, certifikatave, autorizimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe pika 5, “Programimi i të ardhurave sipas niveleve dhe tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak mbështetur në burimet dhe kapacitetet që ka drejtoria”, ngarkon me përgjegjësi specialistin e zyrës z. F. L.

Për sa i përket njoftimit të Inspektoriatit Shtetëror Përgjegjës (ISHT-i), specialistët e terrenit nuk kanë asnjë detyrë funksionale për hartimin e shkresave, njoftimeve, bashkëpunimet ndërinstitucionale.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm dhe dokumentacionit justifikues bashkëngjitur personi përgjegjës i ngarkuar për autorizimin e pikave të karburanteve referuar formularit të përshkrimit të punës pjesë e dokumentacionit bashkëngjitur observacionit është z. F.L.

Drejtorinë e Licencave dhe Transportit disponon databazën e subjekteve që operojnë në fushën e tregëtisë së hidrokarbureve në Bashkinë Kamëz. Për subjektet e rregjistruara gjatë vitit fiskal, Drejtoria e Licencave dhe Transportit do të njoftohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për të kryer njoftimin për dërgimin e dokumentacionit për autorizimin e këtyre subjekteve. Sipas informacionit të mësipërm personi përgjegjës për licencimin e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure duhet të njoftojë Drejtorin e Drejtorisë me relacion përkatës për subjektet të cilat nuk janë të autorizuar. Drejtoria e Licencave dhe e Transportit referuar VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 6.1 citon: “*Në rast se personi juridik nuk riparaqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti licencues në përputhje me parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në riparaqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.*”

Për tarifimin e subjekteve të cilat nuk janë licencuar nuk janë paraqitur argumenta shtesë trajtimi është paraqitur në pikën paisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatët e tyre.

Për sa më sipër, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. E.B.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

2. Znj. G.D., me detyrë përgjegjës i sektorit të terrenit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

3. Z. E.S., me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave familjare në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

4. Z. Sh.L., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Licencave dhe Transportit. Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2023).

-Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

-Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2023.

-Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2023.

-Akt-rakordimet e kryera me degën e thesarit Tiranë për periudhën raportuese të vitit 2023.

-Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2023 Bashkia Kamëz ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihen tre njësi shpenzuese ,aparati i Bashkisë Kamëz ,Ndërmarrja e Gjellbërimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve. Bashkia Kamëz për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranësi dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

□ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Kamëz për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. R.S Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. V.S me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Tiranë në datë 29.03.2023, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave.

Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimet, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz për aktivitetin ekonomiko- financiar për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 16,251,537,123 lekë dhe për vitin 2023 është 19,816,376,662 lekë.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Kamëz në 31.12.2023, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=17,900,371,211 lekë.**

- Aktivet 19,816,376,662 lekë

- Detyrimet 1,916,005,451 lekë

- Aktivet Neto 17,900,371,211 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivitet afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **2,398,692,326 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 630,396,204 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 75,121,320 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 1,693,174,802 lekë

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 630,396,204 lekë, përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 390,630,105 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 222,830,649 lekë.

Lëvizjet e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në **aneksin nr.3/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 630,396,204 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

Fondet e papërdorura për vitin 2023 janë si më poshtë:

1-Trasferte e pakushtëzuar dhe specifike viti 2023 e papërdorur 35,614,324 lekë.

2-Të ardhurat viti 2023 të papërdorura 23,962,576 lekë.

3-Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme rindërtimi viti 2023, 347,952,218 lekë.

4-Donator me vlerë 36,437 lekë

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 407,565,555 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2023.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kamëz në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 75,121,320 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 15,021,300 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 60,100,020 lekë.

Lëvizjet e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, paraqitet në **aneksin nr.3/2** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkuar dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës);

-Fletë hyrje në magazinë;

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës);

-Fletë dalje nga magazine;.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-16,935,450 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 16,935,450 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën 15,021,300 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF1: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	22,403,563
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	109,898,333
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	117,280,596
Gjendja në 31.12.2023	15,021,300

Burimi: Bashkia Kamëz

Bashkia Kamëz ka 3(tre) magazina të ndara, Bashkia, Ndërmarrja e gjelbërimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve.

-Magazina e Bashkisë ka vlerën 3,704,072 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF2: Detajet e magazinës së Bashkisë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	189,735
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	65,414,058
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	61,899,721
Gjendja në 31.12.2023	3,704,072

Burimi: Bashkia Kamëz

-Magazina e Ndërmarrjes së Gjellbërimit ka vlerën 2,284,518 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF3: Detajet e magazinës së Ndërmarrjes së Gjellbërimit:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	998,854
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	13,901,088
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	12,615,424
Gjendja në 31.12.2023	2,284,518

Burimi: Bashkia Kamëz

-Magazina e Ndërmarrjes së Shërbimeve ka vlerën 9,032,711 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF4: Detajet e magazinës së Ndërmarrjes së Shërbimeve:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	21,214,975
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	30,583,187
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	42,765,451
Gjendja në 31.12.2023	9,032,711

Burimi: Bashkia Kamëz

Llogaria 327 “Objekte inventari”, është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën 69,653,208 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF5: Detajet e llogarisë 327 “Objekte Inventari”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	69,653,208
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	6,559,548
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	7,745,723
Gjendja në 31.12.2023	60,100,020

Burimi: Bashkia Kamëz

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Kamëz ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2023, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e Titullarit të Institucionit është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.619 datë 19.10.2023 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2023 të Bashkisë Kamëz.

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka në përbërje:

1-V.S

2-M.Sh

3-F.D

4-M.A

5-F.U

Me urdhër të Titullarit të Institucionit nr.620, datë 19.10.2023 është ngritur grupi për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ka në përbërje:

1-V.P

2-Sh.K

3-M.K

4-F.D

5-M.G

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi sipas relacionit të mbajtur për aktivet e vlerësuara për dalje nga përdorimi ka vlerësuar si mëposhtë:

Pasqyra PF6: Materialet e vlerësuara për daljen nga përdorimi:

Llogaritë	210	212	213	214	218	327	Shuma
	1,405,231	1,886,961	718,946	2,541,982	17,344,254	7,745,723	31,857,897

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Me VKB nr.107, datë 18.12.2023, “Për miratimin e efekteve financiare ekonomike të nxjerrës jashtë përdorimit të pajisjeve me vlerë 24,112,255 lekë si dhe të materialeve me vlerë 7,745,723 lekë.

Me shkresën nr.9664 prot, datë 29.12.2023 në bazë të VKB nr.107, datë 18.12.2023 për nxjerrjen nga përdorimi të pajisjeve me vlerë 24,112,255 lekë si dhe të materialeve me vlerë 7,745,723 lekë është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz dhe nga Komisioni nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve.

Në Bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit u krye transportimi dhe asgjësimi i aktiveve nëpërmjet procesi të groposjes dhe djegies në vendgrumbullimet e përcaktuara.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.3/3** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 721,927,838 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 801,471,292 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2023 ka pasur rritje neto me vlerë 79,543,454 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Financës. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.3/4** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 891,703,510 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është paraqitur në vlerën 891,703,510 lekë. Vlera prej 891,703,510 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF7: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	757,370,354
Paga personeli llog 42	57,477,244

Tatim mbi të ardhurat llog. 431	3,977,185
Sigurime shoqërore llog.435	17,052,990
Sigurime shëndetësore llog.436	2,365,750
Kreditorë të ndryshëm llog. 467	53,459,987
Totali	891,703,510

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4.

Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 212,748,889 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 96,452,463 lekë. Gjatë viti 2023 llogaria 202 ka pasur shtesa në vlerën 5,941,778 lekë për aktivin “Projekt për rikonstruksionin e Shkolles 9 vjeçare Azem Hajdari”. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 20,507,112 lekë dhe vlera neto në vlerën 101,731,092 lekë.

Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” rezulton se projektet e regjistruara në këtë llogari nuk janë vendosur në zbatim.

Amortizimi i llogarisë 202 është kryer në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e kësaj llogarie paraqitet në **Pasqyrën PF8:**

Kosto Historike	Amortizim i akumuluar datë 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim vjetor 2023	Vlera kontabël neto
212,748,889	96,452,463	5,941,778	20,507,112	101,731,092

Burimi: Bashkia Kamëz

Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepricë neto 16,307,379,959 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 12,678,199,077 lekë. Gjatë viti 2023 ka pasur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 4,242,759,689 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 63,548,915 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 3,793,537 lekë shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje për Bashkinë Kamëz dhe NJ.A Administrative. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 688,679,824 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 29,513,711 lekë. Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF9: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim 2023	Pakësime neto 2023	Gjendja me 31.12.2023
210	Toka, Troje, Terrene	58,990,996	290,628,629	-	1,405,231	348,214,364
211	Pyje, Kullota, Plantacione	125,677,932	21,961,827	6,761,281	1,608,000	138,229,203
212	Ndërtime e Konstruksione	3,482,709,070	1,003,472,962	182,353,368	-	4,303,828,664
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	6,832,233,985	2,841,437,423	411,931,958	3,793,537	9,258,987,188
214	Instalime dhe paisje	8,514,352	81,790	2,047,887	-	6,548,255
215	Mjete Transporti	52,011,149	11,208,000	11,657,830	-	51,561,319
218	Inventar Ekonomik	189,724,123	135,369,732	53,420,388	-	271,673,467
	Shuma	12,794,495,503	4,310,102,141	688,679,824	6,806,768	16,409,111,051

1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto historike 58,990,966 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 210 “Toka, troje terrene” ka pasur shtesa në vlerën 290,628,629 lekë. Shtesa e mësipërme gjatë vitit 2023 vjen nga hipotekimi i aktiveve të Bashkisë Kamëz të transferuara përgjatë viteve me VKM. Këto aktive janë kontabilizuar me vlerën e drejtë të aktivitetit.

Aktivet e kontabilizuar gjatë vitit 2023 në llogarinë 210 janë paraqitur në **aneksin nr.3/5** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Gjatë vitit 2023 në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë kontabilizuar 14 aktive me çertifikatë pronësie por pa vlerë kontabël në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale i përmirësuar” pika 8.

Aktivet e kontabilizuar pa vlerë kontabël gjatë vitit 2023 në llogarinë 210 janë paraqitur në **aneksin nr.3/6** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Referuar procedurës së inventarizimit e cila sipas udhëzimit 30 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i cili duhet të kryhet çdo vit, Titullari i Institucionit ka ngritur urdhrin nr.619, datë 19.10.2023 “Për inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e aktiveve për dalje jashtë përdorimit”. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 31.10.2023 për 3 aktive të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” si mëposhtë:

1-Betonite Pastrimi, regjistruar në vitin 2002 në kontabilitet me kosto historike 581,231 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak se ka ndryshuar natyra e këtij aktiviteti. Në këtë aktiv është ndërtuar rrugë e re e cila ka sjell ndryshimin e destinacionit të aktivitetit.

2-Pus Shkolla Bathore, regjistruar në vitin 2002 në kontabilitet me kosto historike 124,000 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak se ka ndryshuar natyra e këtij aktiviteti. Në këtë aktiv është ndërtuar rrugë e re e cila ka sjell ndryshimin e destinacionit të aktivitetit.

3-Lulishte në Kamëz, regjistruar në vitin 2002 në kontabilitet me kosto historike 700,000 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak se ka ndryshuar natyra e këtij aktiviteti. Në këtë aktiv është ndërtuar pallati i kulturës dhe ka sjell ndryshimin e destinacionit të aktivitetit.

Aktivet e mësipërme referuar relacionit të komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të vlerësuar për nxjerrje nga përdorimi me VKB nr.107, datë 18.12.2023 është miratuar dalja nga përdorimi i aktiveve të mësipërme.

2.Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto historike 163,279,747 lekë. Amortizim i akumuluar është në vlerën 37,601,814 lekë dhe amortizim i vitit 2023 është në vlerën 6,761,281 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 211 ka pasur shtesa në vlerën 21,961,827 lekë si mëposhtë:

-Bashkia Kamëz ka pasur shtesa në vlerën 5,401,537 lekë. Nga kjo vlerë blerje e krijuar me pagesë është në vlerën 1,608,000 lekë dhe vlera prej 3,793,537 lekë është sistemim midis llogarive nga llogaria 213 në llogarinë 211.

-Ndërmarrja e Gjellbërimit ka pasur shtesa në vlerën 16,560,290 lekë.

3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” cila pasqyron gjendjen e 149 aseteve për llogari të Bashkisë Kamëz, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerë neto kontabël 3,482,709,070 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksiione” përbëhet prej 161 asete me vlerë kontabël neto 4,303,828,664 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 212 është shtuar në vlerën 1,003,472,962 lekë për 14 projekte investimi dhe është pakësuar për vlerën 1,886,961 lekë për 2 (dy) aktive të nxjerra nga përdorimi

Aktivet e kontabilizuar gjatë vitit 2023 në llogarinë 212 janë paraqitur në **aneksin nr. 3/7** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit. Referuar auditimit të projekteve të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, kontabilizimi është kryer në përputhje me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, për çdo projekt disponohej situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi.

Referuar procedurës së inventarizimit e cila sipas udhëzimit 30 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i cili duhet të kryhet çdo vit, Titullari i Institucionit ka ngritur urdhrin nr.619, datë 19.10.2023 “Për inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e aktiveve për dalje jashtë përdorimit”. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 31.10.2023 për 2 aktive të cilat i përkasin llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” si mëposhtë:

1-Rikonstrukcion WC shkolla e mesme Kamëz, regjistruar në vitin 2000 në kontabilitet me kosto historike 230,153 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak se është dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019.

2-Rikonstrukcion WC shkolla Bathore+ Gropë septike, regjistruar në vitin 2000 në kontabilitet me kosto historike 1,656,808 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak se është dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019.

Aktivet e mësipërme referuar relacionit të komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të vlerësuar për nxjerrje nga përdorimi me VKB nr.107, datë 18.12.2023 ka miratuar daljen nga përdorimi të aktiveve të mësipërme.

Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” janë kontabilizuar pa çertifikatë pronësie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF10** më poshtë.

Pasqyra PF10: Detajet e nënrubrikës “Ndërtesa dhe Konstruksiione”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 31.12.2023
4,276,953,366	794,244,296	1,003,472,962	0	182,353,368	4,303,828,664

Burimi: Bashkia Kamëz

4. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” cila pasqyron gjendjen e 578 aseteve për llogari të Bashkisë Kamëz, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerë neto kontabël 6,832,233,985 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” përbëhet prej aseteve me vlerë kontabël neto 9,258,987,188 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 213 është shtuar në vlerën 2,841,437,423 lekë për 97 projekte investimi dhe është pakësuar për vlerën 1,886,961 lekë për 2 (dy) aktive të nxjerra nga përdorimi

Aktivet e kontabilizuar gjatë vitit 2023 në llogarinë 213 janë paraqitur në **aneksin nr. 3/7** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit. Referuar auditimit të projekteve të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete,vepra ujore”, për çdo projekt disponohej situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi.

Referuar procedurës së inventarizimit e cila sipas udhëzimit 30 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i cili duhet të kryhet çdo vit, Titullari i Institucionit ka ngritur urdhrin nr.619, datë 19.10.2023 “Për inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e aktiveve për dalje jashtë përdorimit”. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 31.10.2023 për 2 aktive të cilat i përkasin llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” si mëposhtë:

1-Lulishtja para komunës, regjistruar në vitin 2000 në kontabilitet me kosto historike 478,946 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak sepse është ndërtuar rrugë.

2-Gjelbërim ambienti në Paskuqan nr.2, regjistruar në vitin 2000 në kontabilitet me kosto historike 240 lekë. Ky aktiv është propozuar për dalje nga përdorimi për shkak sepse në këtë aktiv është ndërtuar rrugë.

Aktivitet e mësipërme referuar relacionit të komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të vlerësuar për nxjerrje nga përdorimi me VKB nr.107, datë 18.12.2023 ka miratuar daljen nga përdorimi të aktiveve të mësipërme.

Aktivitet e kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë kontabilizuar pa çertifikatë pronësie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Lëvizje të aktiveve:

-Lulishte para pallatit të kulturës me vlerë 3,793,537 lekë sistemuar tek llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF11** më poshtë.

Pasqyra PF11: Detajet e nënrubrikës “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 31.12.2023
8,523,553,426	1,691,319,441	2,841,437,423	3,793,537	411,931,958	9,258,987,188

Burimi: Bashkia Kamëz

5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”. Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kamëz. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 6,548,255 lekë. Krahësuar me vitin 2022 llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” është ulur me vlerën 1,966,097 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 81,790 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 2,047,887 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit është në vlerën 2,756,782 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF12** më poshtë.

Pasqyra PF12: Detajet e nënrubrikës “Inventar Ekonomik”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 31.12.2023
29,626,429	21,112,077	81,700	2,756,782	2,047,887	6,548,255

Burimi: Bashkia Kamëz

6. Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Kamëz më datë 31.12.2023 me vlerë neto kontabël 51,561,319 lekë e cila përbëhet prej 32 mjeteve.

Kjo llogari gjatë vitit 2023 është shtuar në vlerën 11,657,830 lekë për blerjen e katër mjeteve.

Bashkia Kamëz mjet transporti administrate me vlerë 2,694,000 lekë.

Bashkia Kamëz mjet transporti administrate me vlerë 2,694,000 lekë.

Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit mjet transporti me vlerë 2,640,000 lekë.

Ndërmarrja e Sërbimeve Publike mjet transporti me vlerë 3,180,000 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF13** më poshtë.

Pasqyra PF13: Detajet e nënrubrikës “*Mjete Transporti*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 31.12.2023
101,000,943	48,989,794	11,208,000	0	11,657,830	51,561,319

Burimi: Bashkia Kamëz

7. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kamëz. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 271,673,467 lekë. Krahësuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventar ekonomik” është shtuar me vlerën 81,949,344 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,341,400 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 5,100,447 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit janë në vlerën 3,191,329 lekë, këto aktive janë të amortizuara dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerë kontabël neto 0 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF14** më poshtë.

Pasqyra PF14: Detajet e nënrubrikës “*Inventar Ekonomik*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 31.12.2023
272,193,317	82,469,195	135,369,732	0	53,420,388	271,673,467

Burimi: Bashkia Kamëz

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (3,438,161,962) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahësuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (665,972,882) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.3/9** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Testi substancial i amortizimit

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Kamëz, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2023 në vlerën 1,928,337,500 lekë. Kjo vlerë e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar i përket kuotave të Bashkisë Kamëz në shoqërinë “U.K” SHA Kamëz me NUIS L.....7 ku Bashkia Kamëz ka 100% të kuotave.

-Bashkia Kamëz në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “U.K” SHA me NUIS L.....7 e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 1,928,337 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,928,337,500 lekë. Vlera e mësipërme është regjistruar në përputhje me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 dhe Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”.

Investimet:

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 1,527,368,829 ndërsa në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 1,008,573,285 lekë. Në llogarinë 231 “Investime” janë kontabilizuar 20 projekte investimi me vlerë investimi 1,008,573,285 lekë. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr. 3/10** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kamëz më datë 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF15: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

	Llogaritë	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	757,370,354	327,280,557	430,089,797
42	Detyrime ndaj personelit	57,477,244	51,129,014	6,348,230
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	3,977,185	3,842,220	180,367
435	Sigurime shoqërore	17,052,990	13,616,854	3,436,136
436	Sigurime shëndetësore	2,365,750	1,888,678	477,072
467	Kreditor të ndryshëm	53,459,987	276,425,785	(222,965,798)

Burimi: Bashkia Kamëz.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2023 për vlerën 757,370,354 lekë, kjo llogari përbëhet si mëposhtë:

-Fatura të muajt nëntor dhe dhjetor të cilat nuk ju ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 413,930,753 lekë dhe përbëhen nga 46 fatura tatimore.

-Fatura të cila i përkasin granteve të kushtëzuara janë në vlerën 252,240,597 lekë dhe përbëhen nga 6 fatura tatimore.

-Fatura të palikujduara për të cilat ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 88,072,528 lekë dhe përbëhen nga 12 fatura tatimore.

-Fatura të Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit për të cilat nuk ka kaluar afati 60 ditor janë në vlerën 1,125,525 lekë dhe përbëhet nga 4 fatura tatimore.

-Fatura tatimore të cilat i përkasin muajt nëntor dhe dhjetor 2023 të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publik janë në vlerën 2,000,950 lekë dhe përbëhen nga 6 fatura tatimore.

Analiza e llogarisë 401 është paraqitur në **aneksin nr. 3/11** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Analiza e llogarisë 404 është paraqitur në **aneksin nr. 3/12** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Kamëz, paraqitet në vlerën 57,477,244 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për

t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2024 në vlerën 57,477,244 lekë.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 3,977,185 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor është paguar në janar 2024 në vlerën 3,977,185 lekë.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 17,052,990 lekë dhe 2,365,750 lekë.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kamëz, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 222,830,649 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2023, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë e të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

Nr.	Objekti	Vlera
1	Qendra shëndetësore Kamëz	1,237
2	Shkolla 9-vjeçare Bathore	99,263
3	Qendra Shëndetësore Valias	135,931
4	Qendra Shëndetësore Kodër Kamëz	46,783
	Total	283,214

Burimi: Bashkia Kamëz.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kamëz, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 53,459,987 lekë.

Pasqyra PF27: Detajet e nënrubrikës “Kreditorë të ndryshëm”

Emërtimi	Subjekti	Nr faturash	Gjendje dt 31.12.2022	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Dt 31.12.2023
Detyrime për shpërbllim lindje	Individ		8,961,000			8,961,000
Shpenzime pagesa e pastrimit të qytetit	E.C shpk	5	55,261,950	43,712,342	55,261,950	43,712,342
Shuma			64,222,950	43,712,342	55,261,950	52,673,342

Burimi: Bashkia Kamëz.

Pasqyra e Performancës Financiare:

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në **aneksin nr.3/13** anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 2,785,620,756 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Tiranë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,534,629,633 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 825,151 lekë e cila përfshin taksën mbi biznesin e vogël, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 36,775,464 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,322,411,447 lekë e cila përfshin taksën e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin, taksën e ndikimit në infrastrukturës etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 254,497,611 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 2,836,300 lekë, e cila përfshin, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 14,787,218 lekë, e cila përfshin tarifat e parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 683,514,110 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli”** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 823,568,442 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 284,985,178 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 “Kontribute për sigurime”** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 131,523,374 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 131,523,374 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 360,686,439 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 360,686,439 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 834,815,746 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 2,785,620,756 lekë dhe totali shpenzimeve është 2,394,990,651 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 390,630,105 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Kamëz).

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Kamëz është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë-pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. V.S dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtori i Burimeve Njerëzore znj. R.H.

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Kamëz, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Kamëz, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2023) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. V.S dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës znj. V.S dhe nga Kryetari Bashkisë z. R.S

Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet në **Pasqyrën PF28** më poshtë:

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2023	922,635	816,697		216,127	300,917	15,066	284,587

Burimi: Bashkia Kamëz

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë paraqitet në **Pasqyrën PF29** më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	922,635	816,697	88
2	F. Sig. Shoq	145,172	128,079	88

Burimi: Bashkia Kamëz

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi, znj. V. S Drejtor i Financës në cilësinë e nënpunësit zbatues.

2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM.

2.4.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

2.4.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Lista e pasurive të paluajtshme të transferuara në Bashkinë Kamëz, sipas VKM-ve përkatëse nr.775 datë 05.09.2013, nr.16 datë 13.01.2022.

-Lista e pasurive të paluajtshme të transferuara në Komunën Paskuqan, sipas VKM nr.454 datë 22.06.2011

-Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruara në kadastër nga viti 2012-2024.

-Listën e pronave të evidentuara në terren për vitin 2023, urdhrat nr.1-21 “Për verifikim e pronave shtetërore”

-Praktikat shkresore me objekt “Kërkesë për status juridik” (2023)

-Praktikat shkresore për regjistrimin e pronave të paluajtshme të Bashkisë Kamëz (2023)

-Kontratat e lidhura për dhënien dhe marrjen me qira të aseteve të Bashkisë Kamëz

-Akt-rakordimi mbi realizimin e të ardhurave për periudhën 01janar 2023-31 Dhjetor 2023

2.4.1.Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë duhet të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin, një proces që përfshinte hartimin e inventarit paraprak, afishimin dhe përditësimin e pasurive dhe në fund miratimin e listës përfundimtare të pronave me vendim të Këshillit të Ministrave.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Kamëz dhe Njesisë Administrative Paskuqan në tabelën e mëposhtme paraqitet informacioni mbi gjendjen e pronave në disponim të Bashkisë Kamëz.

Tabela përmbledhëse nr.1 e pronave Bashkia Kamëz:

Nr	Nj.A	VKM		Në pronësi Në numër	Në përdorimin Në numër	Çertifikuar	Inventarizuar
		Numër	Datë				
1	Bashkia Kamëz	775	05.09.2013	440	647	34	133
2	NJA Paskuqan	454	22.06.2011	106	159	15	
3	Bashkia Kamëz	16	13.01.2022	2		1	
Total				548	806	50	133

Burimi: Bashkia Kamëz

Për Bashkinë Kamëz, lista përfundimtare e pronave është miratuar me VKM nr.775 datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të qarkut Tiranë”, nga ku rezultojnë prona të natyrës si mëposhtë:

-Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore në pronësi, me numër rendor 12 në total 1 pasuri.

-Pronat që përdoren për realizimin e programeve në fushën kulturore dhe sportive në pronësi , me numër rendor 20-24, në total 5 pasuri.

-Prona me funksion varreza në pronësi me numër rendor 41, në total 1 pasuri.

-Prona me funksion infrastrukturë sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike në pronësi me numër rendor 42; 72-82; 85-100; 756-940, në total 213 pasuri.

-Prona me funksion troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji në përdorim, me numër rendor 83; 84, 101-742 në total 644 pasuri.

-Prona me funksion ujësjellës kanalizime në pronësi, me numër rendor 941-951, në total 11 pasuri.

-Prona me funksion bujqësore dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta) në pronësi, me numër rendor 43-52; 55, 62-71; 743, 744, 751, 755, 1447-1634 (vetëm kanalet e treta) në total 212 pasuri.

Gjithashtu me VKM nr.16 datë 13.01.2022, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.775 datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamzë, të qarkut Tiranë” janë transferuar si më poshtë:

-Prona që përdoren në funksion të rindërtimit në pronësi, me numër rendor 1637, 1810 në total 2 pasuri.

Ish-Komuna Paskuqan, aktualisht Njësi Administrative

Lista paraprahe e pronave është miratuar me VKM Nr. 454, datë 22.06.2011 “Për miratimin e listës paraprahe të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Paskuqan të qarkut të Tiranës”, nga ku rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

-Prona për realizimin e programeve arsimore në pronësi, me numër rendor 1-7, në total 7 pasuri ;

-Prona për realizimin e funksioneve në shëndetin publik në pronësi, me numër rendor 8-11 në total 4 pasuri;

-Prona troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve në përdorim me numër rendor 12 në total 1 pasuri;

-Prona me funksion varreza publike në pronësi, me numër rendor 163-165 në total 3 pasuri;

-Prona me funksion të ushtrimit të funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (arë, pemëtore, vreshta, ullishte) në përdorim, me numër rendor 186-188; 190-193;195, në total 8 pasuri;

-Prona me funksion të ushtrimit të funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik toka jo produktive në pronësi, me numër rendor 189, 194 në total 2 pasuri;

-Prona me funksion për zhvillim ekonomik në pronësi, me numër rendor 620 në total 1 pasuri;

-Prona me funksion për infrastrukturë rrugore në pronësi, me numër rendor 197-276 në total 80 pasuri.

Sa i përket certifikatave të pronësisë, rezulton se nga 548 pasuri në total në pronësi, të transferuara me VKM-të përkatëse, janë 57 pasuri total me certifikatë pronësie. Prej të cilave 50 të regjistruara nga Drejtoria e Kadatrës me zbatim të VKM-ve për transferim dhe 7 prej tyre të regjistruara me shpronësim. Lista e pronave të cilat disponojnë certifikatë pronësie paraqitet **në aneksi nr.4/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.


Baza e të dhënave për Bashkinë Kamzë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Kamzë baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të Bashkisë dhe ish-komunës, aktualisht njësia administrative Paskuqan, administrohet në formatin excel. Në strukturën e Bashkisë dhe rregulloren e brendshme, administrimin e pronave dhe ushtrimin e funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin tyre e ka si detyrë funksionale Drejtoria e Kadastrës e cila në vitin 2023 ka evidentuar në terren 133 prona. Procesi i evidentimit të pronave në terren është iniciuar me Urdhrin e Kryetarit Nr.351 Prot. datë 06.06.2023 “Mbi ngritjen e grupit të punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin, plotësimin dhe përditësimin e pronave shtetërore, të transferuara me VKM, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamzë si dhe të pronave që nuk janë transferuar me VKM”.

Rezulton se për procesin e evidentimit në terren të pronave janë mbajtur vetëm procesverbale dhe nuk është mbajtur relacion për këtë proces. Lidhur me vlerësimin e pronave, në vitin 2023 nuk ka

patur grup punë të ngritur për këtë proces dhe nuk ka regjistër të pronave të vlerësuara, por , vlerësimi për 48 pasuri të certifikuar në emër të Bashkisë Kamëz me vlerë 274,328,729 lekë është realizuar nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin Nr.18 datë 28.02.2024 dhe informacioni përkatës i është përcjellë Drejtorisë së Financës me shkresën Nr.1739 Prot., datë 28.02.2024.

Grafiku Nr.2:Pronat e evidentuara në terren



Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1 prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. E.C ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në kuadër të përditësimit të listës së inventarit, është dërguar pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr. 10125 prot, datë 02.12.2024, VKB nr.108, datë 05.11.2024 “Për përditësimin e pjesshëm të listës së inventarit të pronave shtetërore të transferuara në pronësi apo përdorim të Bashkisë Kamëz me VKM nr.775, datë 05.09.2013”.

Në zbatim të VKM-së nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës sipas çmimeve të vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur një grup pune i përhershëm me urdhrin nr.466, datë 10.05.2024, i cili bën përlogaritjen e vlerës së çdo prone që do të certifikohet në emër të Bashkisë Kamëz raporton pranë Drejtorisë së Financës me qëllim pasqyrimin e kësaj vlerë në pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacioni e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Kadastrës dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Bashkia Kamëz argumentet e përcjella i përkasin veprimtarisë së vitit 2024, referuar programit të auditimi nr.1085/1prot, datë 12.09.2024 i ndryshuar i përket periudhës së auditimit 01.01.2023-31.12.2023.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Kadastrës, Bashkia Kamëz ka dërguar për regjistrim 13 praktika për regjistrim dhe 3 kërkesa për status juridik. Tabela e praktikave të dërguara për regjistrim gjatë vitit 2023 paraqitet në **aneksi nr.4/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk janë plotësisht të plotësuar mbi statusin juridik dhe kjo mund të sjelli si pasojë tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes

procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Kjo është justifikuar nga institucioni si mungesë bashkëpunimi me ASHK-në. Si rrjedhojë, inventari rezulton i pa përditësuar plotësisht, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, bazuar në evidencat që subjekti i ka vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se, në territorin administrativ të Bashkisë Kamëz, është miratuar lista përfundimtare e pronave vetëm për Bashkinë me VKM përfundimtare. Për ish komunën Paskuqan, tashmë Njësi Administrative nuk ka listë përfundimtare të pasurive të paluajtshme të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ka vetëm një VKM paraprake. Si pasojë në mungesë së VKM-së përfundimtare, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak.

-Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Kamëz nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të Bashkisë dhe ish-komunës Paskuqan, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, pika 26,27 dhe 28.

Në total, nga 548 pasuri që i janë transferuar në pronësi Bashkisë Kamëz sipas VKM-ve të sipërpërmendura, së bashku me ish Komunën Paskuqan, ku me VKM për miratimin e listës përfundimtare, janë transferuar përfundimisht 440, vetëm 57 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Nga evidencat e shqyrtuara konstatohet se sa i përket certifikatave të pronësisë, për 57 pronat e regjistruara është dokumentacioni përkatës sipas praktikave.

Pyjet, Kullotat, Plantacionet:

Lidhur me pyjet u konstatua se, me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”, i ndryshuar me VKM-në nr.684, datë 02.09.2020, në emër të Bashkisë Kamëz janë transferuar sipërfaqet e mëposhtme pyjore:

Tabela Nr.3 Lista e Inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të bashkisë Kamëz

Nr	Qarku	Bashkia	Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullimore	Ngastra/ nëngastra	Sipërfaqja ha	Kategoria përdorimit e
1	Tiranë	Kamëz	TR37 00 071a	EP Zall Herr-Priskë	71a	23.78	Pyll
2	Tiranë	Kamëz	TR37 00 072a	EP Zall Herr-Priskë	72a	29.77	Pyll
3	Tiranë	Kamëz	TR37 00 073a	EP Zall Herr-Priskë	73a	20.13	Pyll
4	Tiranë	Kamëz	TR37 00 074a	EP Zall Herr-Priskë	74a	22.23	Pyll
5	Tiranë	Kamëz	TR37 00 075a	EP Zall Herr-Priskë	75a	25.71	Pyll
6	Tiranë	Kamëz	TR37 00 077a	EP Zall Herr-Priskë	77a	15.44	Pyll
7	Tiranë	Kamëz	TR37 00 078a	EP Zall Herr-Priskë	78a	18.29	Pyll
Totali						155.35	

Burimi: Bashkia Kamëz

Për sipërfaqet pyjore të transferuara në emër të Bashkisë Kamëz, procesi i regjistrimit nuk ka përfunduar ende. Sipas praktikës shkresore midis Bashkisë Kamëz, ASHK dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, rezulton se për një konflikt kontraktual midis Ministrisë dhe kompanisë së kontraktuar nga Ministria për të kryer regjistrimin e pronave të transferuara me VKM Nr.684/2020, procesi i regjistrimit ka mbetur pezull. Me shkresën nr.5287 prot, datë 06.07.2023, subjekti i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë për informacion mbi ecurinë e procesit. Subjekti ende nuk ka të miratuar, një plan menaxhimi të ekonomisë pyjore.

2.4.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Bashkia Kamëz ka në administrim 155.35 ha transferuar me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”, i ndryshuar me VKM-në nr.684, datë 02.09.2020.

Sipas VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, nuk janë transferuar në pronësi të Bashkisë Kamëz sipërfaqe të llojit kullota, toka joproduktive shkëmbore dhe ujore. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga subjekti, nuk ka kontrata qeraje për sipërfaqet në kategorinë e përdorimit pyll. Bashkia Kamëz ka 8 kontrata qiradhënie të cilat paraqitet në **aneksi nr.4/3** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit dhe 16 kontrata qiramarrje me objekt kontrate për shërbime ambient pune dhe institucione parashkollore dhe shkollore.

Sipas listës së kontratave të qiradhënies, rezulton se ndaj Bashkisë Kamëz ka detyrim të prapambetur disa vjeçar, shoqëria “B” shpk, pasi konflikti mbi shfrytëzimin e pronës së dhënë më qera, është për zgjidhje në proces gjyqësor.

Nga kontratat e lidhura në 2023 është audituar si kampion dosja e rinovimit të kontratës së qirasë midis Bashkisë Kamëz dhe subjektit “P.S” për qiradhënien e pasurisë shtetërore, ambiente brenda Pallatit të Kulturës, të llojit ndërtesë, pjesa e nëndheshme me sipërfaqe 101,4 m2 në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Kamëz.

Sipas dokumentacionit në dosjen e praktikës së qiradhënies së objektit të mësipërm, është i paqartë statusi juridik i pronës, pasi në dokumentet për hartimin e kontratës fillestare të objektit, ky i fundit referohet si në pronësi, dhe më tej si pronë në përgjegjësi administrimi.

Paqartësia lidhur me statusin e pronës, lë të paqartë zbatimin e VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga Bashkia Kamëz është paraqitur observacioni me shkresën nr. 532/1 prot., datë 15.01.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 1085/5 prot., datë 20.01.2025, nga z. F.Sh në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Administrimit dhe Menaxhimit të Aseteve ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar projekt raportit të auditimit të përcjell me shkresën nr. 1085/4, datë 16.12.2024 jam ngarkuar me përgjegjësi për auditimin e Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Administrimit dhe Menaxhimit të Aseteve për periudhën e auditimit 01.01.2023-31.12.2023. Bashkëngjitur në observacion gjendet urdhri i emërimit nr. 539, datë 03.06.2024 si Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Administrimit dhe Menaxhimit të Aseteve. Dokumentacioni i mësipërm do të konsiderohet në hartimin e raportit përfundimtar të auditimit.

Për sa më sipër, observacioni merret në konsideratë.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara më sipër, mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike trajtuar më hollësisht në aktkonstatim ngarkohen me përgjegjësi:

Z. G.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit, Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve.

Z. E.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore.

IV. REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua: Mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me Kodin e Etikës dhe Rregulloren e Bashkisë. Mungojnë raportimet periodike nga një pjesë e drejtorive, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva, Bashkia nuk ka hartuar Planin e Veprimit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2023. Bashkia Kamëz, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Këto veprime dhe mosveprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 , pika 20, neni 10 pika 2, shkronja “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1, 3.3, Kreu II kap. 2.2.6 .*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, dhe Koordinatorin e MFK-së, të marrin masa për: Hartimin e planeve të trajnimit për njohjen e punonjësve lidhur me bazën rregullatore të Bashkisë dhe Kodin Etik, hartimin e planeve vjetore për trajnimet e brendshme për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të Bashkisë, hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit gjithëpërfshirëse, si dhe hartimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përbërjes dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se dosjet e auditimeve të realizuara në vitin 2023 nuk janë arkivuar në njësinë e arkivit të institucionit, në kundërshtim me *normat tekniko-profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa që të arkivojë dosjet e auditimit të realizuara dhe të ndjekë këtë praktikë në përfundim të auditimeve në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës, në bazë testimi, në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacion shoqërues në Degën e Thesarit Tiranë, u konstatua se, për vitin 2023 ky afat nuk është respektuar për 3 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën **67,019,817 lekë**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrin masa për likuidimin në kohë, të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i pranimit të faturës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën **2,218,217 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **1,808,971 mijë lekë** ose në masën **81.55%** me një diferencë mosrealizimi në vlerën **409,246 mijë lekë**.

Referuar vlerës 409,246 mijë lekë të mosrealizimit disa prej zërave fiskal të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë;

- “Taksë ndërtese biznes” është planifikuar në vlerën 77,250 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 55,056 mijë lekë ose realizuar në masën 71%.

- Taksë e gjelbërt biznes” është planifikuar në vlerën 18,401 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 677 mijë lekë ose realizuar në masën 3.68 %.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- “Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 24,684 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 40,203 mijë lekë ose realizuar në masën 162%.

- “Tarifë pastrim mbetjesh biznes” është planifikuar në vlerën 85,149 mijë lekë ndërsa arkëtimet në vlerën 101,848 mijë lekë ose realizuar në masën 119%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra tejkallime të theksuara mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real dhe shfaq mangësi, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura, veprime në kundërshtim me nenin 34, pika 1-5 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që, gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të kryej parashikime bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, si dhe arkëtimet nga debitorët për taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse, me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë dhe kryerjes së shpenzimeve të planifikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se dosjet individuale për subjektet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Kamëz nuk janë të plota. Nga shqyrtimi i dosjeve për 44 subjekte të përzgjedhur në mënyrë rastësore rezultoi se:

- Dosjet nuk janë të pajisura me fletën e inventarit.

- Në dosje nuk paraqitet dokumentacioni kronologjik për subjektin duke filluar nga momenti i hapjes, dokumentacionin e që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, tabelës për qëllim reklamimi etj.

- Në dosje nuk janë të dokumentuara akt verifikime vjetore të inspektorëve.

- Gjithashtu nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem (për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifatat vendore), pra ndryshimet në sistem janë bërë pa dokumentacion vërtetues pa procesverbalet e ndryshimit në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note).

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 29, 36, 69, 75; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”; VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për “Sistemin e taksave dhe tarifatat vendore në Bashkinë Kamëz”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 45-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që, të plotësojë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosjet e subjekteve tatim-paguese, ndryshimet në sistem në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore, të shoqërohen me dokumentacionin përkatës vërtetues, duke kryer monitorimin e kësaj procedure.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë kontabilizuar 14 aktive me certifikatë pronësie, por jo me vlerë të plotë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika njohja e AAGJ në pasqyrat financiare dhe në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale i përmirësuar” pika 8. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Kontabilitetit të marrë masa për vlerësimin dhe kontabilizimin e aktiveve në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” me vlerë të drejtë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare 2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” është shtuar në vlerën 1,003,472,962 lekë për 14 projekte investimi.

Referuar auditimit të projekteve të cilat janë kontabilizuar në këtë llogari konstatohet se nuk është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika njohja e AAGJ në pasqyrat financiare, për çdo projekt disponohej situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi, por nuk disponohej dokumentacioni i pronësisë së aktiveve.

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 212 janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie, në kundërshtim me pikën 2 “Aktivet afatgjata”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.5 datë 21.02.2022.

Gjatë vitit 2023 llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është shtuar në vlerën 2,841,437,423 lekë për 97 projekte investimi, ku është konstatuar e njëjta situatë për mungesën e dokumentacionit të pronësisë.

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 213 janë pa certifikatë pronësie, në kundërshtim me pikën 2 “Aktivet afatgjata”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 5 datë 21.02.2022.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve dhe Investime, Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të aseteve të marrë masa që për asetet të cilat do të kryhen investime kapitale, të disponojnë dokumentacionin e pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Kamëz më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 137,194,411 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 222,830,649 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për 4 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Kamëz janë ngurtësuar fonde në vlerën 283,214 lekë. Nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Tiranë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve, sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Projekteve

dhe Investimeve dhe Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 283,214 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, të marrin masa, për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 dhe duke njoftuar subjektet, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për të sistemuar dhe zhbllokuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vetëm 9.1% e pronave janë të pajisura me certifikatë pronësie dhe inventarët e pasurive të paluajtshme nuk janë të përditësuara lidhur me disponimin e pjesës tjetër të pronave të transferuara. Mungesa e përditësimit të inventarit, mos disponimi i pronave konform kuadrit ligjor me kontrata qiraje për pronat në përdorim nga palët e treta dhe mungesa e certifikatave të pronësisë mund të sjellë si pasojë tjetërsimin e mundshëm të pronave përmes procedurave të legalizimit, privatizimit dhe vendimet gjyqësore. Inventari rezulton i pa përditësuar plotësisht, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve të marrin masa për inventarizimin e plotë të pasurive të paluajtshme, duke e përditësuar vazhdimisht inventarin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Kamëz nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të Bashkisë dhe ish-komunës Paskuqan, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë, në kundërshtim me Udhëzimin e MF me Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 26, 27 dhe 28. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe të Kontabilitetit duhet marrin masa për të krijuar, përditësuar dhe administruar një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se gjatë periudhës 2011-2022 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet VKM-ve në Bashkinë Kamëz janë transferuar 1,352 pasuri nga këto 548 pasuri në pronësi dhe 806 pasuri në përdorim. Në Bashkinë Kamëz me VKM nr. 775, datë 05.09.2013 janë transferuar 1087 pasuri nga këto 440 pasuri në pronësi dhe 647 pasuri në përdorim, me VKM nr. 16, datë 13.01.2022 janë transferuar 2 pasuri.

Në NjA Paskuqan me VKM nr.454, datë 22.06.2011 janë transferuar 265 pasuri nga këto 106 pasuri në pronësi dhe 159 pasuri në përdorim.

Nga pasuritë e transferuara 50 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 806 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 498 pasuri nuk janë pajisur me çertifikatë pronësie. Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Kadastrës, Bashkia Kamëz ka dërguar për regjistrim 13 praktika për regjistrim dhe 3 kërkesa për status juridik.

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i papërditësuar. Veprime këto në kundërshtim me neni 37 i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që: Drejtoria e Kadastrës dhe Administrimit të Aseteve të vazhdojë procesin e certifikimit të pasurive publike, të cilat kanë kaluar në pronësi sipas VKM-ve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua për sipërfaqet pyjore të transferuara në emër të Bashkisë Kamëz, procesi i regjistrimit nuk ka përfunduar ende. Sipas praktikës shkresore midis Bashkisë Kamëz dhe ASHK dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, rezulton se për një konflikt kontraktual midis Ministrisë dhe kompanisë së kontraktuar nga Ministria për të kryer regjistrimin e pronave të transferuara me VKM nr. 684/2020, procesi i regjistrimit ka mbetur pezull. Me shkresën nr. 5287 prot., datë 06.07.2023, subjekti i është drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë për informacion mbi ecurinë e procesit. Subjekti ende nuk ka të miratuar, një plan menaxhimi të ekonomisë pyjore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të vijojë komunikimin ndër-institucional, për të adresuar çështjen e krijuar si pasojë e problematikës së evidentuar, pasi kjo e fundit bie brenda kuadrit administrativ dhe nuk mund të pengojnë zbatimin e kuadrit ligjor për funksionimin e institucionit të Bashkisë Kamëz.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit në dosjen e praktikës së qiradhënies së objektit me kontratën nr. 6588 prot., datë 08.09.2023, është i paqartë statusi juridik i pronës, pasi në dokumentet për hartimin e kontratës fillestare të qirasë së objektit, ky i fundit referohet si në pronësi dhe më tej, si pronë në përgjegjësi administrimi. Paqartësia lidhur me statusin e pronës, lë të paqartë zbatimin e VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike, duhet të shqyrtojë përpara hartimit të kontratës, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të hartojë dispozitat e kontratës me referencë të saktë. Në përfundim të hartimit dhe nënshkrimit të kontratës, duhet të bashkëlidhi si aneks të kësaj të fundit, dokumentacionin e saktë, mbi të cilin është lidhur kontrata.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se detyrimet e abonentëve privatë për taksat dhe tarifave vendore që kanë ndaj Bashkisë Kamëz deri në datën 31.12.2022, detyrimi tatimor ka qenë në vlerën 85,866,370 lekë për 395 abonentë privatë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë paguar nga abonentët privatë detyrime të prapambetura në vlerën 7,508,243 lekë dhe është krijuar detyrim tatimor në vlerën 48,627,106 lekë për 200 subjekte. Detyrimi tatimor për abonentët privatë është i kontabilizuar. Vlera progresive në datë 31.12.2023 është në vlerën 126,985,233 lekë për 595 abonentë privatë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me *Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, *Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara"*, nenet 88-104, *Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, *Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe *Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore"*, neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri në datën 31.12.2023, në vlerën totale 126,985,233 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Tiranë është dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve, e shoqëruar me leje legalizimi.

Nga auditimi konstatohet se debitorë nga vitet e mëparshme në datë 01.01.2023 për taksën e infrastrukturës janë në vlerën 297,508,793 lekë dhe përbëhet nga 8,608 debitorë.

Për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 25,123,258 lekë për 183 persona. Për detyrimet e krijuara gjatë vitit 2023 kanë paguar 192 persona me shumë 10,398,474 lekë. Në datën 31.12.2023 për taksën e ndikimit në infrastrukturë kemi në total debitorë 9,087 persona, me vlerë 312,233,577 lekë shumë e cila është e ardhur e pa arkëtuar për Bashkinë Kamëz. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Kamëz, për periudhën ushtrimore ka njoftuar subjektet debitorë, por nuk u evidentuan raste që institucioni t'i jetë drejtuar ASHK-së, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekare. Veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*, neni 27, pika "d", *Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe *VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim"* i ndryshuar, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 45-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kamëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet

informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë detyrimi 312,233,577 lekë ndaj 9,087 personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kamëz me palët e treta konstatohet se:

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Kamëz ka rinovuar 2 kontrata qiraje me afat 1-vjeçar të cilat janë lidhur fillimisht në vitin 2022. Aktualisht Bashkia Kamëz disponon 4 kontrata aktive të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi, kurse gjatë vitit 2023 janë maturuar 2 kontrata qiraje. Për vitin 2023 kanë qenë aktive 8 kontrata me sipërfaqe totale 21,309 m² me vlerë kontrate 3,287,150 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitin 2023 -OE “S.S” SHPK dhe “P.S” Pf nuk ka shlyer detyrimin për kontratat në shumën 163,860 lekë detyrim 3 mujor dhe 13,218 lekë kamatëvonese.

- OE “B” SHPK është në proces gjyqësor;

- OE “G” SHPK ka detyrim shumën 8,820 lekë.

Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbarimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit sipas kontratave të qirasë në shumë **185,898 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë nga taksat dhe tarifat vendore që kanë ndaj Bashkisë Kamëz, u konstatua se deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor ka qenë në vlerën 796,779,587 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë paguar nga debitorët familjarë detyrime të prapambetura në vlerën 17,425,898 lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 150,504,806 lekë. Detyrimi tatimor për abonentët familjarë është kontabilizuar në vlerën 188,692,749 lekë. Vlera e detyrimit e pakontabilizuar është në shumën 741,165,746 lekë.

Vlera progresive në datë 31.12.2023 është në vlerën 929,858,495 lekë për 41,254 abonentë familjarë.

- Detyrime nga abonentët familjarë sipas sistemit DTTV në vlerën 840,650,579 lekë për 30,841 debitorë;

- Detyrime nga abonentët familjarë sipas agjentit tatimor UKK SHA në vlerën 89,207,916 lekë për 10,413 debitorë;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe me strukturat e tjera, që në aktivitetin e tyre sigurojnë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, të analizojnë situatën debitorë dhe të hartojnë një plan masash periodik dhe vjetorë:

- Për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;

- Për rritjen e arkëtimeve nga ana e debitorëve me qëllim minimizimin e vlerës progresive të debisë prej 929,858,495 lekë, për 41,254 debitorë familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në datën 31.12.2022 totali progresiv i detyrimeve është në vlerën 456,046 mijë lekë, nga të cilat detyrime me burim financimi të ardhurat e veta janë në vlerën 210,762 mijë lekë dhe me burim financimi buxhetin e shtetit janë në vlerën 245,284 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 543,188 mijë lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 625,306 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të në datën 31.12.2023 është në vlerën 373,927 mijë lekë. Nga këto, detyrime të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta janë në vlerën 137,904 mijë lekë dhe detyrime të prapambetura nga Buxheti i Shtetit janë në vlerën 236,023 mijë lekë. Detyrimet e prapambetura nga të ardhurat e veta janë të klasifikuara si më poshtë:

1-“Investime” në shumën 88,072,528 lekë e cila i përket 12 projekteve të investimit.

2-“Fatura shërbime” në shumën 43,712,342 lekë i përket shërbimit të pastrimit të qytetit.

3- “Fatura mallra” në shumën 6,120,000 lekë.

Detyrimet e prapambetura janë raportuar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1316 prot, datë 14.02.2024 në përputhje me udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Nga sa më sipër, rezulton se Bashkia Kamëz nuk ka trajtuar me prioritet likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe ka marrë angazhime buxhetore, pa pasur fonde në dispozicion. duke krijuar detyrimeve të reja, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 52, Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 47, pika 1, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e paguara të vitit paraardhës,

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se në territorin e Bashkisë Kamëz për vitin ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitet 42 subjekte, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatua se gjatë vitit 2023, 21 subjekte kanë rinovuar licencën. Gjatë vitit 2023 nga 21 subjekte të cilat kanë rinovuar licencën, 4 subjekte janë pajisur me licencë me afat mbi 1 vit dhe 17 subjekte janë pajisur me licencë me afat 1-vjeçar, për të cilët është përlllogaritur detyrimi 202,000 lekë në kundërshtim me VKM Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9 detyrimi duhet të përlllogaritet në shumën 1,000,000 lekë. Sa më sipër konstatohet se vlera e cila duhej përlllogaritur dhe arkëtuar është në shumën 17,000,000 lekë. Nga kjo shumë janë kontabilizuar, 3,400,000 lekë dhe shuma 13,600,000 lekë nuk ju është ngarkuar si detyrim, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatuar se në territorin e Bashkisë Kamëz kanë operuar 14 subjekte me aktivitet tregtimin me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve, pa u pajisur me autorizim përkatës nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit. Drejtoria e Licencave dhe Transportit gjatë vitit 2023 ka lejuar veprimtarinë e 14 subjekteve pa autorizim përkatës në kundërshtim me VKM-në me Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 15.1. Nga Drejtoria e Licencave dhe Transportit, këto subjekte janë ngarkuar me detyrim vjetor. Duke mos pasur autorizim për këto subjekte nuk lind detyrim tatimor, por, për këto subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizim duhet vepruar sipas VKM-së së mësipërme. Vetëm subjekteve të cilat pajisen me autorizim, u lind detyrim tatimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 45-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Licencave dhe e Transportit, Bashkia Kamëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 2,424,000 lekë për 12 subjekte të cilave u është rinovuar autorizimi gjatë vitit 2023 dhe njoftimin e 17 subjekteve për debinë e konstatuar në shumën 13,600,000 lekë dhe fillimin e procedurës së arkëtimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Rekomandimi: Drejtoria e Licencave dhe e Transportit, Bashkia Kamëz, të njoftojë Inspektoratin Shtetëror, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kamëz, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 4 punonjës si më poshtë:

1. Z. E. B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

2. Znj. G.D, në cilësinë e përgjegjës së sektorit të terrenit.

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

3. Znj. L.K, në cilësinë e përgjegjës së sektorit të vlerësimit të detyrimit dhe menaxhimit të borxhit.

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

4. Z. E.S, në cilësinë e përgjegjës të sektorit të taksave familjare.

Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” i ndryshuar.

5. Z. Sh. L, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Licencave dhe Transportit.

Për mos zbatimin e kërkesave të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015.

D. 2. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. Z. G.M, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit dhe Menaxhimit të Aseteve. Për mos zbatimin e kërkesave të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

E. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Mat, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT